



Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore

AUTOSTRADËS A2: BUKOJÇANI - KËRÇOVË SEKSIONIT

Kornizë për Blerje të Tokave



Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore

AUTOSTRADËS A2: BUKOJÇANI – KËRÇOVË SEKSIONIT

Kornizë për Blerje të Tokave

LLOJ I DOKUMENTIT (VERSIONI) PUBLIC

NUMRI I PROJEKTIT 70061173

OUR REF. NO.

DATA: MARS 2020



Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore

AUTOSTRADËS A2: BUKOJÇANI – KËRÇOVË SEKSIONIT

Kornizë për Blerje të Tokave

Jozhe Jovanovski

Menaxher për Mbrojtje të Mjedisit dhe Aspekte Sociale, Njësia për implementim të Projektit,
NPRRSH

Telefoni: +38923118044 ext. 305

Adresa: Dame Gruev 14, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Email: j.jovanovski@roads.org.mk

Uebfaqja: www.roads.org.mk

KONTROLLI I CILËSISË

Çështja/revizioni	Çështja e parë	Revizioni 1	Revizioni 2	Revizioni 3
Vërejtje	Drafti i raportit final për komente	I dytë	I tretë	Komente nga NPRRSH/PESR
Data	korrik 2019	gusht 2019	tetor 2019	mars 2020
Përgatiti	Tatyana McNaughton	Tatyana McNaughton	Tatyana McNaughton	Matthew Shepherd
Nënshkrimi				
Kontrolloi	Rachael Bailey	Rachael Bailey	Rachael Bailey	Tatyana McNaughton
Nënshkrimi				
Autorizuar nga	Rachael Bailey	Rachael Bailey	Rachael Bailey	Rachael Bailey
Nënshkrimi				
Projekti numër	70061173	70061173	70061173	70061173
Raporti numër	1.0	2.0	3.0	4.0

PËRMBAJTJA

1	HYRJE	1
2	PËRSHKRIM I PROJEKTIT	3
2.1	ZONA E PROJEKTIT, PËRDORIMI I TOKËS DHEPËRMBLEDHJA E ANALIZËS SOCIO-EKONOMIKE	3
2.2	KOMUNITETET LOKALE NË ZONËN E PROJEKTIT	4
2.3	PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT LIDHUR ME IMPAKTET NGA BLERJA E TOKËS	6
	KRITERET TOKËSORE TË PROJEKTIT	6
	PËRMBLEDHJE E IMPAKTEVE TË ZHVENDOSJES EKONOMIKE DHE FIZIKE	7
3	KORNIZA LIGJORE DHE RREGULLATORE	9
3.2	KORNIZA NACINALE LEGJISLATIVE	9
3.3	PËRSHKRIM I PROCEDURËS PËR ESKPROPRIJIM	11
3.4	HAPA TË MËTUTJESHËM QË DUHET TË NDËRMERREN NGA AUTORITETET RELEVANTE	12
3.5	PËRMBLEDHJE E KRITEREVE TË EBRD	13
3.6	DALLIMET KYÇE NDËRMJET LEGJISLACIONIT NACIONAL DHE KRITEREVE TË EBRD DHE VEPRIMEVE TË PROPOZUARA	14
4	PARIME, OBJEKTIVA DHE PROCEDURA	23
4.1	OBJEKTIVAT	23
4.2	PARIME	23
4.3	BLERJA E TOKËS, PROCESI I ZHVENDOSJES DHE KTHIMIT TË EKZISTENCËS	25
5	RASTE TË VEÇANTA	28
5.2	PRONA QË GJENDEN NË TAMPON ZONËN E SIGURISË PREJ 40METRAVE	28
5.3	GRUPE TË LËNDUESHME	28

6	KUALIFIKIMI DHE E DREJTA	30
6.1	KUALIFIKIMI PËR NDIHMË PËR KTHIM TË EKZISTENCËS	30
6.2	MATRICA E TË DREJTAVE	31
6.3	NDIHMË PËR RIVENDOSJE DHE KTHIM TË EKZISTENCËS	36
	NDIHMË PËR RIKTHIM TË EKZISTENCËS	36
7	ZBATIM I AKTIVITETEVE DHE MONITORIM I BLERJES SË TOKËS³⁷	
7.2	REGJISTRI I POPULLATËS DHE I INVENTARIT DHE HULUMTIM SOCIO-EKONOMIK	37
7.3	IDENTIFIKIM I SHËRBIMEVE TË LIRA DHE PROGRAME PËR PËRKRAHJE TË PNP/PAP TË LËNDUESHËM	37
7.4	MONITORIMI	37
8	PUBLIKIMI I INFORMATAVE DHE KONSULTIMEVE	40
8.1	ANGAZHIM I PLANIFIKUAR I ARDHSHËM I FAKTORËVE	40
9	MEKANIZËM PËR ANKESA	42
10	PËRGJEGJËSIA INSTITUCIONALE	43

TABLES

Tabela3-1 – Dallimet kyçe ndërmjet legjislaconit nacionale dhe kriterëve të EBRD	15
Tabela4-1 – Lista e aktivitetëve që do të ndërmerren	25
Tabela6-1 – Matrica e të drejtave	31
Tabela7-1 – Shembuj të Indikatorëve të Monitorimit	38

Ky raport është përgatitur nga WSP në emër të Ndërmarrjes Publike për Rrugët e Shtetit. GEING Krebs und Kiefer International kanë ndihmuar në kompletimin e këtij raporti përmes sigurimit të informacioneve për projektin dhe mbështetjes në terren

1 HYRJE

- 1.1.1. The European Bank for Reconstruction and Development (EBRD or the Bank) është duke e shqyrtuar mundësinë për të siguruar financa për Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore (NPRRSH/PESR) për ndërtim të segmentit të autodtradës A2 Bukojçani deri në Kërçovë.
- 1.1.2. Huaja do të përdoret për të financuar ndërtimin e nën-seksionit Bukojçani – Kërçovë të segmentit të autostradës A2, (Projekti). Projekti përfshin: nënkalime, sisteme kullimi, tubacione, 3 ura, 3 viadukte dhe një tunel në Kolibari. Projekti do të përfshijë punime të përkohshme, duke përfshirë ndërtim të rrugëve për hyrje dhe kampe ndërtimi.




Figura1-1–Traseja e Propozuar e Projektit

- 1.1.3. Ky dokument është Korniza për Blerje të Tokës (KBT ose LAF) për Autostradën prej 10.7 km Bukojçani – Kërçovë. Në të janë përshkruar objektivat, parimet dhe qasja e planifikuar për blerje të tokës dhe kompensim për zhvendosje ekonomike dhe fizike dhe restaurimin e ekzistencës.

- 1.1.4. Kjo KBT/LAF i paraqet impaktet nga zhvendosja që ndërlidhet me Projektin dhe kompensimin dhe parimet dhe përgjegjësitë për të siguruar që askush të mos mbetet i dëmtuar si pasojë e Projektit. KBT/LAF përfshin edhe një mekanizëm për ankesa që personat dhe publiku i përgjithshëm të prekur nga projekti t'i ngritin çështjet e tyre.
- 1.1.5. Ky dokument është zhvilluar në pajtim me kornizën ligjore të Maqedonisë së Veriut dhe në pajtim me Politikën Mjedisore & Sociale 2014 (PMS/ESP 2014), konkretisht Kriteret për performim 5 (KP5) – Blerje e tokës, Zhvendosje jovullnetare & Zhvendosje ekonomike. Plan i detajuar për Blerje të Tokës (PBT/LAP) që i mbulon edhe zhvendosjen ekonomike edhe atë fizike do të zhvillohet në vazhdim mbi bazën e parimet e përkufizuara në këtë KBT/LAF.
- 1.1.6. KBT/LAP-ja është ndryshe nga PBT/LAP, ku KBT/LAF e përcakton qasjen e planifikuar të Projektit për blerje të tokës dhe kompensim, e jo detajet e plota për pronësi faktike të truallit. Numri i saktë i palëve të prekura, që do të përcaktohen në PBT/LAP. Gjatë fazës së ardhshme të zhvillimit të projektit do të zbatohet regjistrim i popullatës dhe studim i inventarit të aseteve për të mësuar plotësisht shkallën dhe përmasat e zhvendosjes ekonomike dhe fizike dhe impaktet relevante mbi Personat e Ndikuar nga Projekti (PNP/PAP).
- 1.1.7. Regjistrimi i popullatës dhe analiza të inventarit të aseteve si dhe studime socio-ekonomike do të jenë pjesë për PBT/LAP të ardhshëm në bazë të informuar për Projektin pasi të harmonizohet ruta e trasesë të përcaktohet dhe rezultatet e regjistrimit të popullatës dhe të inventarit të aseteve do të jenë në dispozicion.
- 1.1.8. Kjo KBT/LAF është strukturuar si në vijim:
- Seksioni 2: Përshkrim i Projektit – i përshkruan Projektet dhe i përmbledh impaktet e mundshme lidhur me blerjen e tokës
 - Seksioni 3: Kornizë ligjore dhe rregullatore – i përshkruan kornizat nacionale ligjore dhe kërkesat e EBRD si dhe i identifikon boshllëqet dhe mënyrën e adresimit të tyre
 - Seksioni 4: Blerje e tokës dhe Objektivat, Parimet dhe Procesi i Kompensimit
 - Seksioni 5: Rastet speciale
 - Seksioni 6: Kualifikimi dhe të drejtat
 - Seksioni 7: Implementim i Aktiviteteve për Blerje të Tokës dhe Monitorim
 - Seksioni 8: Publikim i Informatave dhe Konsultime
 - Seksioni 9: Mekanizëm për Ankesa
 - Seksioni 10: Përgjegjësitë Instrukionale

2 PËRSHKRIM I PROJEKTIT

2.1 ZONA E PROJEKTIT, PËRDORIMI I TOKËS DHEPËRMBLEDHJA E ANALIZËS SOCIO-EKONOMIKE

- 2.1.1. Autostrada A2 Bukojçani–Kërçovë, është pjesë e Korridorit VIII. 305 km të Korridorit VIII, gjendet në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe e bën lidhjen nga kufiri me Bullgarinë deri në kufirin me Shqipërinë. Autostrada do të zhvillohet për të përmirësuar lidhjet rrugore brenda vendin, si dhe me vendet fqinje dhe për të përmirësuar shkëmbimin ekonomik dhe social ndërmjet tyre.
- 2.1.2. Terreni ekzistues përgjatë rutës së propozuar karakterizohet me male dhe terren të rrafshë i ndërthurur me rrjedha të përhershme dhe të përkohshme ujore të cilat derdhen në Lumin e Zajazit. Pjesa malore e rutës përbëhet nga gurë të fortë, kurse terreni i rrafshë është kryesisht tokë e punueshme me vegjetacion. Rruga ekzistuese nacionale drejt Ohrit është paralele me rutën e miratuar, si dhe me vijën hekurudhore të planifikuar Kërçovë - Gostivar, që kryqëzohet me rutën e propozuar në disa lokacione.
- 2.1.3. Format primare të transportit në zonën e projektit janë me vetura, furgoni dhe autobusi. Komunitetet lokale që gjenden përgjatë rutës së propozuar kanë popullatë në rënie, si rezultat i migrimit të të rinjve në kryeqytet ose në shtete tjera. Shtëpitë për banim në atë zonë janë kryesisht objekte me një ose dy kate në gjendje mesatarisht të mirë.
- 2.1.4. Karakteristikat kryesore të trashëgimisë përgjatë trasesë së Projektit i përfshijnë varreza dhe përmendore. Projekti do të kalon në afërsi të madhe të tre varrezave dhe një memoriali të luftës.
- 2.1.5. Projekti përfshin një viadukt, mbi varrezat në Strogomishtë të Poshtme, për çka do të mund të kërkojë zonë të përkohshme për punë brenda varrezave për të ndërtuar dy shtylla të viaduktit dhe zhvendosje të atyre varrezave që mund të gjenden brenda asaj zone. Për këtë viadukt janë hartuar tre opsione të dizajnit, një me kalata që shtrihen në varreza dhe dy me kalata të vendosura jashtë varrezave. Opsioni / varianti do të zgjidhet në konsultim me komunitetin lokal. Nëse kërkohet zhvendosja e varreve, do të përgatitet një Plan i zhvendosjes së varreve, në konsultim me komunitetin lokal dhe autoritetet përkatëse, siç përcaktohet në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social për Projektin.



Figura 2-1 - Varrezat lokale



Figura 2-2–Nëna Shqiptare–Memoriali i dedikuar për shqiptarët e rajonit, të cilët janë vrarë gjatë Luftës së Dytë Ballkanike (1913)

- 2.1.6. Projekti është dizajnuar për të mundësuar harmonizimin më të mirë për t'i plotësuar parametrat e dizajnit, duke i marrë parasysh kufizimet, sikur topografia dhe vija hekurudhore.
- 2.1.7. Ka disa shtëpi të cilat gjenden në afërsi të rutës së propozuar (që është e kufizuar nga nevoja për t'u arritur ngritja e duhur për të mbikaluar vijën hekurudhore), në afërsi të udhëkryqit të propozuar në Strogomishte, ku ruta e propozuar kalon nëpër fshatin Strogomishte e Epërme. Shtëpive që janë më së afërmi duhet t'u jepet mundësia që të përfshihen në procesin e shpronësimit, nëse nuk dëshirojnë të jetojnë ngjitur me njëjtë e shkëmbimit.
- 2.1.8. Zonën e karakterizojnë kompani të vogla individuale, zakonisht të vendosura rreth shtëpive apo në afërsi të tyre, që zakonisht përbëhen nga parcela tokësore me shtëpi, si dhe konstruksione të vogla (p.sh. depo/hangarë) dhe sipërfaqe për kultivim të produkteve. Në seksionin e vijës së propozuar në afërsi të Kërçovës ka edhe zgjue me bletë.
- 2.1.9. Në zonën e nyjes Kërçovë, paralelisht me rrugën ekzistuese nacionale shtrihet vija hekurudhore Kërçovë-Gostivar. Për ndërtimin e nyjes, autostrada, si vijë kryesore, duhet të kalon përtej rrugës ekzistuese nacionale dhe vijës hekurudhore me lartësi të lirë në pajtim me standardet relevante.
- 2.1.10. Ruta e propozuar gjithashtu përfshin 14 kalime rrugore, ku dy nga kalimet rrugore kalojnë nëpër trasenë e propozuar (mbikalime) dhe 12 të tjerat kalojnë nën trasenë e propozuar (nënkalime).
- 2.1.11. Dizajni i detajuar i projektit është në proces të finalizimit dhe pritet përfundimisht të rregullohet më në tremujorin e parë të vitit 2021. Pastaj vlerësohet se perioda e ndërtimit do të zgjatë 3 vite.

2.2 KOMUNITETET LOKALE NË ZONËN E PROJEKTIT

- 2.2.1. Në bazë të informatave të siguruar nga raporti i ESIA, personat me prejardhje maqedone janë kryesisht të përqendruar në zonat urbane, si rezultat i industrializimit dhe formave të migrimin të popullatës në vitet e 1960-ta dhe 1970-ta. Qytetarët me prejardhje etnike

shqiptare kryesisht gjenden në zonat rurale në kuadër të komunës në veri të qytetit dhe më afër qytetit të Kërçovës.

- 2.2.2. Të dhënat më poshtë e paraqesin përbërjen etnike të popullatës në katër fusha që kanë të bëjnë me projektin: zona më e gjerë e Komunës Kërçovë, vetë zona e projektit, konkretisht fushat rurale në zonën e Projektit dhe qyteti i Kërçovës. Disa vite pas regjistrimit të popullatës në vitin 2002, komuna Kërçovës u bashkua me komuna tjera lokale dhe të dhënat më të fundit zyrtare do të vërtetohen pas regjistrimit të ardhshëm të popullatës.




Figura 2-3–Përbërja etnike e popullatës në Zonën e Projektit, të dhëna nga regjistrimi i popullatës në vitin 2002, (Burimi: ESIA, 2019)

- 2.2.3. Raporti i ESIA sugjeron që të dhënat nga regjistrimi i fundit i popullatës ishin planifikuar të grumbullohen në vitin 2011, ndërsa regjistrimi i popullatës në vitin 2011 kishte filluar mirëpo procesi është ndërprerë dhe prolonguar në kohë të papërcaktuar, ashtu që ato nga viti 2002 janë të dhënat nga regjistrimi i fundit i popullatës, të cilat janë në dispozicion.
- 2.2.4. Situata demografike në zonën e projektit është paraqitur më poshtë, ku të dhënat tregojnë dominancë të grave të kategorisë mbi moshën 70+, të cilat mbase jetojnë vetëm dhe për këtë arsye mund të kenë dobi nëse marrin pjesë në diskutim të organizuar veçmas me grup fokusi gjatë konsultimeve publike.
- 2.2.5. Në bazë të vëzhgimeve në terren gjatë vizitës së parë për njohje të lokacionit, është vërejtur që njerëzit që jetojnë në zonën e projektit janë kryesisht shqiptarë. Disa nga familjet që jetojnë në trasenë e projektuar rezultojnë të jenë relativisht konzervativ dhe për këtë arsye gjatë konsultimeve publike do të duhet të organizohen konsultime specifike (p.sh. grupe fokusi) për të përfshirë pikëpamjet si dhe mendimet e grave dhe të moshuarve lidhur me Projektin.
- 2.2.6. Në zonën e Pevcit, që është vizituar nga NPRRSH/PESR dhe ekipet e WSP në korrik të vitit 2019, NPRRSH/PESR ka konfirmuar që traseja e propozuar e rrugës ka mundësi të ndikon zonën e banuar me familjet lokale rome. Pas shqyrtimit të rutës së propozuar në hartë me dizajnuesit e rrugës, ekipi ka identifikuar deri në tetë (8) ekonomi shtëpiake lokale

rome që mund të jenë të ndikuara nga projekti nëse traseja e rrugës në zonën e Pevcit nuk ndryshohet.

- 2.2.7. Përveç kësaj, është vërejtur që disa fusha që gjenden rreth trasesë së propozuar, i punojnë banorët lokal të cilët kultivojnë lakra, misër dhe kultura tjera vjetore.




Figura 2-4–Struktura e Popullatës në Komunën Kërçovë me njësi dallimi prej 5 viteve dhe moshë (Burimi: Uebfaqja e Entit Shtetëror për Statistikë, Databaza e MAKStat)

- 2.2.8. Detaje shtesë mbi karakteristikat socio-ekonomike të popullatës mund të gjenden në dokumentacionet e përgatitura nga ESIA për Projektin.

2.3 PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT LIDHUR ME IMPAKTET NGA BLERJA E TOKËS

KRITERET TOKËSORE TË PROJEKTIT

- 2.3.1. Tjetërsim i përhershëm i tokave mbase është i nevojshëm për realizim të Projektit, duke përfshirë nyje, struktura të lidhura dhe hyrje/modifikime dhe ndërtime të rrugëve lokale (që janë pjesë e spektrit të Projektit), etj. Zona e përhershme e tokës që do të blihet do të duhet të konfirmohet pasi dizajni detajor të jetë i finalizuar dhe ruta të jetë e përcaktuar. NPRRSH/PERS dhe dizajnesit e tyre janë duke kërkuar mënyra për ta minimizuar zhvendosjen fizike.
- 2.3.2. Do të identifikohet zonë përgjatë rutës për hedhje të mbeturinave (p. sh. teprica e materialit nga vendi i gërmuar) gjatë dizajnit të detajuar dhe do të vendoset në tokë shtetërore.

- 2.3.3. Në pajtim me Ligjin për rrugë shtetërore, do të vendoset tampon zonë sigurie prej 40metrave në të dy anët e rrugës që do të jetë subjekt për disa restriksione gjatë fazës operacionale të Projektit. Pronarët e tokave në këtë zonë sigurie do të duhet të kërkojnë leje, nga NPRRSH/PESR, për ndërtim të objekteve të reja dhe që strukturat ekzistuese të mbesin brenda tampon zonës së sigurisë prej 40metrave.
- 2.3.4. Projekti gjithashtu do të implikon konfiskim të përkohshëm të tokës për: shtigje për transport/ndërtimi; zona ndërtimi dhe kampe; ruajtje të përkohshme të materialeve dhe tokës; prerje të pemëve etj. Megjithatë, asnjë informacion mbi marrjen e tokës së përkohshme nuk është në dispozicion në kohën derisa zhvillohet kjo Kornizë. Sapo të përcaktohet modeli përfundimtar dhe itinerari, këto informacione do të konfirmohen dhe përfshihen në PBT/LAP.

PËRMBLEDHJE E IMPAKTEVE TË ZHVENDOSJES EKONOMIKE DHE FIZIKE

- 2.3.5. Impaktet e zhvendosjes ekonomike dhe fizike mund të jenë si në vijim:
- Aktualisht 8 shtëpi në Strogomishte të Poshtme do të jenë në afërsi të madhe të trasesë rrugore (gjithashtu brenda tampon zonës për siguri prej 40metrash) dhe në këtë mënyrë do të jenë të përfshira në shkëputjet pjesëve të vogla të parcelave të tyre private (në të cilat gjenden shtëpitë e tyre), si dhe të ekspozuara ndaj shkallëve të zmadhuara të niveleve të pluhurit, zhurmës dhe emetimeve edhe gjatë ndërtimit edhe gjatë përdorimit të rrugës. Pas shqyrtimit të trasesë, NPRRSH/PESR dhe dizajnerët e saj do të vërtetojnë nëse impaktet janë të kufizuar në shkëputjen e këtyre parcelave.
 - Përveç kësaj, dizajnerët e rrugës aktualisht janë duke shqyrtuar mënyra për të zvogëluar impaktet mbi 8 ekonomitë shtëpiake në komunitetin rom në Pevci (Figura 2-5 në faqen tjetër) disa prej të cilave mund të ketë nevojë për t'i zhvendosur, rrjedhimisht të ekzistojë mundësia të nxitet zhvendosje fizike.
 - Projekti gjithashtu ka mundësi të shkaktojë zhvendosje ekonomike, ku fusha të caktuara që për momentin kultivohen nga komunitetet lokale (me misër, lakra dhe kultura tjera sezonale) ndoshta do të duhet të eksproprijohen për të lejuar zhvillimin e Projektit.
- 2.3.6. Impaktet e mëtutjeshme mund të përfshijnë:
- Bazuar në vëzhgimet e realizuara gjatë muajit korrik 2019 gjatë vizitës në terren, rrugët ekzistuese të brendshme të cilat i përdorin fshatarët janë të ngushta, disa janë të gjera për më pak se dy vetura. Gjatë konsultimeve në Strogomishte të Poshtme, që u mbajtën si pjesë e vizitës në terren, banorët lokalë gjithashtu kanë përmendur që nënkalimi hekurudhor në afërsi, që përdoret për hyrje në fshat është aq i ngushtë sa që automjetet për raste urgjente dhe ndihmë të shpejtë shpesh kanë vështirësi për të kaluar nëpër të. Kjo informatë sugjeron që rrugët e ngushta mund të jenë problematike dhe mund të jenë përkohësisht dhe konsiderueshëm të dëmtuara gjatë fazës së ndërtimit.
 - Në afërsi të trasesë së rrugës ka gjithsej tre varreza (brenda 40metrave të trasesë), këtu bëjnë pjesë: Varrezat e qytetit Kërçovë; Varrezat në Strogomoshte të Poshtme; dhe Varrezat në Cërvivci.




Figura 2-5–Zhvendosje potenciale fizike e familjeve të komunitetit rom në Pevci (Burimi: ESIA, 2019)

- 2.3.7. Detaje shtesë për impaktet mund të gjenden në Seksionin 5 të këtij dokumenti.
- 2.3.8. NPRRSH/PESR për momentin është duke punuar me dizajnerët e rrugës për të siguruar që traseja përfundimtare do të minimizojë impaktet nga blerja e tokës aty ku është e mundur.

3 KORNIZA LIGJORE DHE RREGULLATORE

- 3.1.1. Projekti duhet t'i plotësojë kriteret nacionale dhe të EBRD, legjislative dhe standarde, veçanërisht, në veçanti 5 KP të EBRD-s për Blerje të Tokës, Zhvendosje jovullnetare dhe Dislokim ekonomik.

3.2 KORNIZA NACINALE LEGJISLATIVE

- 3.2.1. Ligji për eksproprijim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 95/12, 131/12, 24/13, 27/14 dhe 104/15) <http://www.finance.gov.mk/mk/node/3102>, e rregullon procedurën për eksproprijim të pronës për projekte të cilat janë me interes publik dhe të drejtat e ndërlidhura për patundshmëritë.
- 3.2.2. Ndërtimi i rrugëve shtetërore është pjesë e kategorisë së projekteve të interesit nacional/publik dhe në këtë rast NPRRSH/PESR si realizues do t'i parashtrorë të gjitha dokumentet e nevojshme për dizajnin e projektit së bashku me kërkesën për eskproprijim të tokës në zyrat relevante për çështje juridike dhe pronësore.
- 3.2.3. Ligjet në vijim i rregullojnë pronësinë tokësore, të drejtat pronësore dhe blerjen e tokës në Republikën e Maqedonisë së Veriut:
- Ligji për Kadastrën e patundshmërive (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 55/13) i rregullon ndryshimet dhe plotësimet për kadastrën nacionale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 115/14).
 - Ligji për të dhënat hapësinore për infrastrukturë nacionale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 38/14).
 - Ligji për obligacione ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 18/01, 78/01, 04/02, 59/02, 05/03, 84/08, 81/09, 161/09).
 - Ligji për eksproprijim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 95/12, 131/12, 24/13, 27/14 dhe 104/15) e rregullon procedurën për eksproprijim të pronës duke e përfshirë tokën, strukturat dhe objektet tjera për qëllime të ndërtimit dhe aktivitete të cilat konstatohet se janë në interes të publikut.
- 3.2.4. Sipas Ligjit për eskproprijim të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kompensimi nuk mund të jetë më i vogël se vlera e tregut të pronave të prekura dhe përlogarit në bazë të transaksioneve të fundit në treg për sipërfaqet në fqinjësi. Vlera e tregut të patundshmërive që eksproprijohen përcaktohet nga vlerësues të autorizuar të pronave/vëzhgues në pajtim me Ligjin për vlerësim. Sipas ligjit, kompensimi mund të jepet ose në formë të pronës për zëvendësim ose me para kesh. Aty ku ofrohet patundshmëri tjetër si kompensim për pronë të eskproprijuar, e njëjta duhet të jetë e përafërt me vlerën e pronës së eskproprijuar. Ligji nacional lejon kompensim për humbje të profitit/të ardhurave nëpërmjet aktiviteteve të prekura afariste, ku skenar i tillë është shkaktuar nga procesi i eksproprijimit. Pronari i pronës e cila është në proces eskproprijimi ka të drejtë për kompensim për të gjitha bimët/kulturat, fushat e mbjellura, pyjet në tokën dhe pemoret, me kusht që ato nuk janë të përfshira në vlerën e tregut të tokës.
- 3.2.5. Ky ligj gjithashtu e përcakton eskproprijim të përkohshëm të tokës, duke përfshirë:

- Eksproprijim i përkohshëm i tokës për qëllim të Implementimit të hulumtimeve të hollësishme gjeologjike për lëndë të para, në pajtim me Ligjin për lëndë të para minerale—eskproprijim i përkohshëm mund të zgjatë gjashtë vite nga dita kur toka është transferuar në pronësi, përkatësisht, derisa të skadojë periudha për të cilën është dhënë e drejta për Implementim të hulumtimeve të hollësishme gjeologjike, dhe
- Eskproprijimi i përkohshëm i tokës së rrethinës për qëllim të punimeve ndërtimore dhe për realizim të punimeve të interesit publik—eskproprijimi i përkohshëm i tokës në rrethinë mund të zgjasë më së shumti deri dy vite.

- 3.2.6. Kompensimi për kufizimet mbi të drejtat për pronësi tokësore përcakohet në pajtim me normën minimale të tregut, për pronë të ngjashme dhe kohëzgjatjes së qirasë. Nëse është shkaktuar dëm mbi pronarin e pronës nëpërmjet kufizimit të të drejtës së tij për pronësi tokësore, pronari ka të drejtë për dëmshpërblim. Dëmshpërblimi në raste të tilla përcaktohet sipas rasteve nga ekspertë të certifikuar, në pajtim me Ligjin për ekspertizë.
- 3.2.7. Nëse, si rezultat i eskproprijimit të përkohshëm të tokës, dëmi mbi kapacitetet e parcelave tokësore dhe potencialin bujqësor nuk mund të kthehet mbrapa dhe nuk mund të përdoret në mënyrë dhe për qëllimin për të cilin është përdorur para këtij impakti, pronari i tokës mund të kërkon eskproprijim të plotë të parcelës brenda një viti nga dita e skadimit të eskproprijimit të përkohshëm nga realizuesi dhe kontraktuesi i tyre.
- 3.2.8. Nëse, gjatë procesit të eskproprijimit, pjesa tjetër e parcelës së prekur tokësore e bën konsiderueshëm më të vogël (kështu duke krijuar të ashtuquajturat “Tokë Jetime”) që mund të ndikon interesin ekonomik të pronarit, ai/ajo mund të kërkon eskproprijim të parcelës në tërësi dhe të kompensohet në tërësi.
- 3.2.9. Pronari i pronës së eskproprijuar nuk ka të drejtë për kompensim për çfarë do investimi që bëhet pasi propozimi për eskproprijim të jetë parashtruar në organet kompetente (Datapërfundimtare).
- 3.2.10. Kompensimin për të gjitha pronat e eskproprijuara dhe kostot e procedurës i mbulon pala e cila e inicon procesin për eskproprijim.
- 3.2.11. Ligji nacional nuk përcakton masa të veçanta lidhur me grupet e lëndueshme. Qendrat komunale për punë sociale mund të ofrojnë ndihmë, në bazë të Ligjit për mirëqenie sociale. Ky ligj mundëson sigurim të pagesave për ndihmë sociale dhe shërbime për banorët raste sociale, siç është përkufizuar me ligj. Një nga aspektet e rëndësishme të pagesave për ndihmë sociale, sipas ligjit, e përcakton të drejtën e personit për shpërblim të njëfishtë financiar kur personi i tillë gjendet në situatë me nevojë të përkohshme ose të papritur, përkatësisht kur për shembull të drejtat e tyre për banim janë të eskproprijuara.
- 3.2.12. Ndihmë shtesë nga organet për punë sociale mund të përdoret për të adresuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara, familjet me vetëm një të punësuar, familjet me të ardhura të ulëta, etj. Republika e Maqedonisë së Veriut ka gjithashtu një serë ligjesh me të cilat persona të prekur mund të shfrytëzojnë ndihmë për të përmirësuar standardet e tyre jetësore (p. sh. shërbime shëndetësore, arsim, dokumente personale, banesa sociale etj.) dhe këto ligje mund të përdoren si bazë për të planifikuar aksione të mëtutjeshme për kthim të banimit/ekzistencës, veçanërisht për grupet e lëndueshme.

- 3.2.13. Ndhimë juridike mund t'u ofrohet personave të lëndueshëm sipas Ligjit për ndihmë juridike falas nga avokatë të përcaktuar nga Ministria për Drejtësi dhe asociacionet e përzgjedhura të qytetarëve.
- 3.2.14. Aspektet kyçe të Ligjit për eskroprijim janë me sa vijon:
- Kompensimi – Kompensimi do të përcaktohet në bazë të nenit 18:“Për pronën e eksproprijuar duhet të ofrohet kompensim i proporcional që nuk mund të jetë më i ulët se vlera tregtare e pronës. Vlera tregtare e pronës do të përcaktohet me kushte të përcaktuara me këtë ligj, në pajtim me metodologjinë, rregullat dhe standardet sipas Ligjit për vlerësim”. Neni 18 gjithashtu përcakton “e drejta për të kërkuar kompensim për pronën e eksproprijuar nuk mund të shkelet”;
 - Neni 37 përcakton që vlera tregtare e pronës së eksproprijuar dhe prona që është dhënë do të përcaktohet si kompensim nga vlerësues/vëzhgues të kualifikuar, në pajtim me Ligjin për vlerësim;
 - Kompensimi për pronën e eksproprijuar do të përcaktohet në bazë monetare përveç nëse realizuesi dhe pronari i pronës së përfshirë nuk merren vesh për kompensim apo sigurim të mjeteve si zëvendësim të pronës;
 - Pronari i pronës së eksproprijuar gjithashtu mund të ketë të drejtë për kompensim për kulturat, bimët dhe drunjtë në tokën e vet. Vlera e kulturave, bimëve dhe drunjve (dhe prodhimi i tyre) zakonisht përlllogaritet si artikull i posaçëm në kategorinë e dëmeve;
 - Pronari i pronës nuk do të ketë të drejtë për kompensim për investime të cilat bëhen pas datës së parashtrimit të propozimit për eskroprijim (datë e përlllogaritjes) neni 40.

3.3 PËRSHKRIM I PROCEDURËS PËR ESKPROPRIJIM

- 3.3.1. Procedura për eskroprijim i përfshin hapat në vijim:
- 3.3.2. NPRRSH/PESR e inicion procesin për eskroprijim duke parashtruar propozim në zyrën e Avokatit të Shtetit. Propozimi për eskroprijim përmban të dhëna për:
- NPRRSH/PESR– si palë e cila e propozon eskroprijimin;
 - Të gjitha pronat dhe mjetet për të cilat propozohet eskroprijimi;
 - Listën e pronarëve të mjeteve dhe pronave të tilla (emra, vendbanimi, vendqëndrimi, etj);
 - Detaje për të gjitha të drejtat relevante për patundshmërinë e propozuar për eskroprijim (pronari, qiramarrësi, etj); dhe
 - Lloji i projektit/punës për çka propozohet ky eskroprijim.
- 3.3.3. Sipas Ligjit për eskroprijim, me propozimin për eskroprijim kërkohen edhe këto dokumente shtesë:
- Ekstrakt nga dokumenti për planin afatgjatë apo projekt të miratuar infrastrukturor;
 - Raport nga studim i tokës për prona të patundshme për të cilat është propozuar eskroprijim;
 - Shuma e kompensimit për patundshmërinë për të cilën propozohet eskroprijim është e bazuar në vlerën tregtare për prona të palëvizshme të përcaktuar nga vlerësues të autorizuar në pajtim me Ligjin për vlerësim, si dhe në plan për pagesë të kompensimit;
 - Kopje të certifikatës për pronësi mbi patundshmërinë për të cilën është propozuar eskroprijim;
 - Prova për mjete të siguruara për kompensim.

3.4 HAPA TË MËTUTJESHËM QË DUHET TË NDËRMERREN NGA AUTORITETET RELEVANTE

- 3.4.1. Avokati Shtetëror, në bazë të propozimit të pranuar i kontrollon të gjitha dokumentet dhe dërgon vendim në Ministrinë për Financa, Zyrën për Çështje Juridike dhe Pronësore (trupi për eskroprijime) e konfirmon propozimin për eskroprijim. Pas pranimi të këtij vendimi, trupi për eskroprijim(në këtë rast, NPRRSH/PESR):
- pronarit i dorëzon propozim për eskroprijim me të gjitha dokumentet relevante (dhe aty ku ka mundësi, edhe shfrytëzuesve) të pronës për të cilën propozohet eskroprijim në afat prej pesë ditëve nga dita e pranimi të vendimit të Avokatit Shtetëror;
 - në Agjencinë për Kadastër të patundshmërive e parashtron propozimin për eskroprijim dhe raportin për studim të tokës në mënyrë të që japin mendime, në afat prej pesë ditëve nga dita e pranimi të vendimit të Avokatit Shtetëror;
- 3.4.2. Trupi për eskroprijim pastaj përcakton seancë dëgjimore/takim për propozimin për eskroprijim në të cilën e fton pronarin e pronës dhe (aty ku është e mundur) shfrytëzuesit e saj për të diskutuar procesin e eskroprijimit. Nëse pronari nuk mund të kontaktohet, përcaktohet përfaqësues i përkohshëm i pronarit të vërtetë, për t'u siguruar që procesi nuk vonohet.
- 3.4.3. Seanca dëgjimore/mbledhja mund të ofrojë tre përfundime të ndryshme:
- Marrëveshje për kompensim
- 3.4.4. Marrëveshja e përcakton shumën e kompensimit, pavarësisht nëse sigurohet me para kesh apo me kompensim si zëvendësim (me vlerë të përafërt tregu) dhe afatin për të gjitha pagesa e dakordësuara. Marrëveshja e arritur regjistrohet dhe nënshkruhet nga pronarët e patundshmërisë dhe (aty ku është e mundur), nga shfrytëzuesit e pronës.
- 3.4.5. Marrëveshja e nënshkruar ka fuqi ligjore për eskroprijim dhe metodën e dakordësuar për kompensim. Marrëveshja e nënshkruar gjithashtu paraqet bazë për ndryshim të të drejtave pronësore për patundshmërinë pasi të jetë paguar shuma e kompensimit.
- Vendim ekzekutiv për eskroprijim
- 3.4.6. Në raste kur nuk mund të arrihet marrëveshje, trupi për eskroprijim përgatit dhe parashtron një sërë dokumentesh tek autoritetet për eskroprijim (zyra e Avokatit Shtetëror) me provat për inkuadrim/takim me pronarët, kompensim të ofruar dhe shkaqet përse pronari e ka refuzuar ofertën. Zyra e Avokatit Shtetëror është e obliguar për të sjellur vendim përfundimtar në afat prej 20 ditëve nga pranimi i propozimit për eskroprijim dhe pjesën tjetër të dokumentacionit.
- Udhëzim i mëtejshëm në gjyq
- 3.4.7. Ankesë kundër vendimit të Avokatit Shtetëror mbi çështjen për eskroprijim mund të parashtrohet në Gjykatën administrative në afat prej 15 ditëve nga dita e parashtrimit të vendimit për eskroprijim. Nëse nuk është parashtruar ankesë kundër vendimit, prona mund të përdoret nga NPRRSH/PESR (p. sh. NPRRSH/PESR ka qasje në pronën e përfshirë), ndërsa zgjatë procesi i negociatave për kompensim deri në momentin kur të ketë marrëveshje ndërmjet dy palëve.

- Proces i kompensimit
- 3.4.8. Propozuesi i eskproprijimit (në këtë rast, NPRRSH/PESR) është e i obliguar të paguan kompensim të plotë për pronën e eskproprijuar, në afat prej 30 ditëve nga dita kur vendimi gjyqësor për kompensimin hyn në fuqi.
- 3.4.9. Nëse NPRRSH/PESR, nuk siguron kompensim të plotë brenda prej këtyre 30 ditëve, është e obliguar të paguan dëmshpërblim, përkatësisht, normën ditore sipas normës referente sipas Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- 3.4.10. Për eskproprijim të përkohshëm të tokës, çështjet lidhur me sigurim të kompensimit për tokë dhe prona të dëmtuara gjithashtu mund të zgjidhen nëpërmjet Implementimit të Ligjit për obligacione. Parimisht, ky ligj përcakton dhënie të kompensimet me para kesh për pronarët formal ligjor të tokës dhe pronave (apo atyre, të drejtat e të cilëve njihen me ligjet nacionale) për dëme apo humbje të shkaktuara si rezultat i aktiviteteve të realizuesve. Kompensimi për raste të tilla sigurohet pasi të kenë ndodhur dëmet dhe/ose humbjet. Rastet, kur pala e cila ka shkaktuar dëm/humbje dhe personi i dëmtuar nuk mund të arrijnë marrëveshje për shumën e kompensimit, zgjidhen nga gjykatat kompetente.

3.5 PËRMBLEDHJE E KRITEREVE TË EBRD

- 3.5.1. Pesë parimet e kriterëve të EBRD për Projekt që kanë të bëjnë me zhvendosjen ekonomike dhe fizike mund të përmbledhen si vijon:
- të shmangët apo, së paku të minimizohet zhvendosja ekonomike dhe fizike e shkaktuar nga projekti kurdo të jetë e mundur duke kërkuar dizajne alternative projekti; aty ku zhvendosje është e pashmangshme, duhet të përgatitet kornizë apo plan përkatës për rikthimi përkatëse të mjedisit jetësor dhe për rivendosje;
 - zbutje të impakteve negative sociale dhe ekonomike nga blerja e tokës apo ndalesat ndaj shfrytëzimit dhe qasjen e personave në parcelën, objektet fizike ose resurset natyrore duke u siguruar që aktivitetet për restaurimin e botës së gjallë planifikohen dhe zbatohen me publikim adekuat të informatave, konsultime dhe pjesëmarrje të informuar të personave të prekur;
 - përmirësim i kushteve jetësore ndërmjet personave të zhvendosur fizikisht nëpërmjet sigurimit të banimit adekuat;
 - për persona të cilët nuk kanë vërtetim ligjor për tokën të cilën e punojnë, Përpiluesi do t'u ofron zgjedhje të opsioneve për banim përkatës me siguri për pronësi që të mund të vendosen legalisht pa qenë të detyruar të përballen me dëbim të detyruar;
 - Në bazë të konsultimeve me persona të tillë të zhvendosur, klienti do të ofron ndihmë të mjaftueshme për ata të rikthejnë dhe aty ku është e mundur, të përmirësojnë standardin e tyre jetësor në vend përkatës alternativ;
 - përmirësim apo, në minimum, rikthim i ekzistencës, kapacitetit për të fituar të ardhuradhe standet jetësore të personave të zhvendosur, duke i përfshirë ata të cilët nuk kanë të drejta të përcaktuara ligjore apo deklaron pronë mbi tokën (aktualisht në fushën e prekur të projektit në kohën e datës përfundimtare), për nivelet para-projektit dhe përkrahje të tyre gjatë periudhës së tranzitimit;
 - për të siguruar kompensime të veçanta për ndihmë të personave apo grupeve me pengesa ose të lëndueshme (aktualisht në fushën e konkrete të projektit në kohën e datës përfundimtare) që mund të jenë më fortë të ndikuar nga zhvenduar se sa personat

tjerë dhe që mund të jenë të kufizuar në aftësinë e tyre për të deklaruar apo të shfrytëzojnë ndihmën për ekzistencë dhe beneficinet e lidhura me aktivitetet.

- të vendoset mekanizëm për ankesa për të pranuar dhe me kohë të adresohen çështje konkrete për zhvendosje dhe rikthim të ekzistencës që janë parashtruar nga persona të zhvendosur.

Lista e sipërme është vetëm përmbledhje e 5 kritereve për KP të EBRD dhe është e kualifikuar duke iu referuar tekstit të plotë të politikës së zbatueshme:

<http://www.ebrd.com/news/publications/policies/environmental-and-social-policy-esp.html>.

3.6 DALLIMET KYÇE NDËRMJET LEGJISLACIONIT NACIONAL DHE KRITEREVE TË EBRD DHE VEPRIMEVE TË PROPOZUARA

- 3.6.1. Boshllëqet kryesore mes ligjit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe 5 PR-ve të EBRD relevante për këtë Projekt janë përmbledhur në Tabelën 3-1. Zhvendosja dhe kompensimi i personave të prekur do të zbatohet në pajtim me kornizën nacionale ligjore në fuqi dhe 5 Kriteret e EBRD për Performans në Politikën Mjedisore dhe Sociale (2014). Aty ku shfaqen moskonzistenca ndërmjet legjislacionit nacional dhe kritereve të EBRD, do të miratohen standarde më të rrepta. Ky dokument (duke i përfshirë të drejtat përkatëse dhe kriteret për përshtatshmëri) përmban masa për bajpasim të këtyre boshllëqeve.

Tabela3-1 – Dallimet kyçe ndërmjet legjislacionit nacionalë dhe kritereve të EBRD

Aspektet kryesore	Legjislacioni nacional	5KP-të e EBRD	Aksione për mbyllje të boshllëkut
Shmangiedheminimizim i zhvendosjesjovullnetare	Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik që përcakton se qëllimi i planifikimit të tillë, ndër të tjerat, është të sigurohet përdorim i organizuar dhe racional i hapësirës si dhe përmirësim i kushteve jetësore dhe të punës për qytetarët (Neni 4).	Të shmangët apo minimizohet zhvendosje jovullnetare nëpërmjet hulumtimit të alternativave për dizajn të projektit. Huamarrësi do të merr parasysh alternativa të realizueshme të dizajneve të projektit apo së paku të minimizojë zhvendosjen	NPRRSHdo të kërkojë minimizim të zhvendosjes fizike dhe ekonomike Të gjitha alternativat dhe masat e hulumtuara për shmangie apo minimizim të impaktit negativ do të regjistrohen në komunikimet e brendshme periodike me Bankën.
Blerje e Tokës, Kompensim, Planifikim i rivendosjes &restaurim të ekzistencës	Ligjet e Maqedonisë nuk obligojnë për përgatitje të rivendosjes apo korniza/plane për rikthim të ekzistencave.	Aty ku ndonjë projekt mund të shkakton zhvendosje ekonomike osefizike, me kornizë do të do të paraqiten parimet e përgjithshme, procedurat dhe korniza e të drejtave me 5 kriteret e EBRD përperformans. Pasi të përcaktohen komponentët individualëtë projektit dhe të publikohen informatat e kërkuara, korniza do të shërbejë si bazë për zhvillim të Planit të detajuar Aksional për Rivendosje (PAR) ose Planin për Rikthim të Ekzistencës (PRE).	NPRRSH/PESR do të përgatitë Plan për Blerje të Tokës (PBT/LAP)
Pjesëmarrje dhe Konsultim	Nuk ka kërkesa specifike, mirëpo përfshin angazhim me pronarët dhe shrytëzuesit e pronave në suaza të kornizës ligjore sipas ligjit për shpronësim	EBRD kërkon publikimin përkatës të të gjitha informatave relevante, të cilat realizuesi do t'i shqyrton me persona dhe komunitete të prekura si dhe të lehtësojë pjesëmarrjen e tyre të hershme dhe të informuar në proceset vendimarrëselidhur me potencialin për zhvendosje, në pajtim me 10 KR-të:	NPRRSH/PESR është konsultuar me udhëheqësit lokla fetar në zonën e projektit për ende nuk ka filluar programi i tyre i konsultimeve. Si të tilla, nuk janë mbajtur konsultime të gjera me banorët lokal apo familjet rome deri më sot. Personat dhe komunitetet e prekura (duke i përfshirë grupet apo individët e lëndueshëm) do të konsultohen ngaNPRRSH-ja për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të lehtë dhe të informuar në proceset vendimmarrëse për t'u

Aspektet kryesore	Legjislacioni nacional	5KP-të e EBRD	Aksione për mbyllje të boshllëkut
		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Affected persons shall be given the opportunity to participate in the negotiation of the compensation packages, eligibility requirements, resettlement assistance, suitability of proposed resettlement sites and the proposed timing. ▪ Special provisions shall apply to consultations which involve as individuals belonging to vulnerable groups. ▪ Consultation will continue during the implementation, monitoring, and evaluation of compensation payment and resettlement so as to achieve outcomes that are consistent with the objectives of PR 05 and 10. 	<p>siguruar që aktivitetet e blerjesdhe kompensimit janë zbatuar me publikim të informatave dhe konsultime përkatëse. Ky segment zbatohet në pajtim me dispozitat e përfshira në PMS dhe lejon konsultimet të shtuara me grupe të lëndueshme dhe potencialisht të marginalizuara.</p>
<p>Plotësim i kushteve për kompensim</p>	<p>Ligji për shpronësim i identifikon personat që i plotësojnë kushtet për të drejta ligjore mbi tokat dhe struktura, siç janë regjistruar nga Kadastra e patundshmërive dhe ata të drejtat e të cilëve janë të pranuar (ose mund të legalizohen) sipas legjislacionit nacional (pronësi faktike).</p>	<p>5 KR-të EBRD i njohin ata që nuk kanë të drejtë ligjore apo vërtetim për tokën të cilën e shfrytëzojnë në Datën e fundit. Persona të tillë janë të pranueshëm për ndihmë për rehabilitim dhe kompensim për humbje të pronave jotokësore me vlerën për zhvendosje dhe gjithashtu ka nevojë për inkuadrim në procesin e konsultimeve.</p>	<p>Kompensimi dhe ndihma për PNP/PAP pa të drejta ligjore apo vërtetime do të sigurohet në bazë të parimeve dhe të drejtave të siguruara në matricën e të drejtave në këtë dokument, nëse gjenden në zonën e prekur nga projekti në kohën e datës së fundit. Regjistrimi i pronave dhe vlerësimi i pronave të tyre të prekura do të realizohet dhe të gjitha masat do të regjistrohen si pjesë e regjistrimit të popullatës dhe të inventarit.</p>

Aspektet kryesore	Legjislacioni nacional	5KP-të e EBRD	Aksione për mbyllje të boshllëkut
	<p>Veti e rëndësishme e Ligjit për shpronësim në Maqedoni është që i njëjti lejon kompensim për objektet e ndërtuara pa leje (p. sh. pa leje valide).</p> <p>Kompensimi për objektet pa leje valide përcaktohet me shumë e cila përkon me vlerën e tyre ndërtimore, p. sh. vlera tregtare e materialeve dhe kostot për punimet.</p>		
<p>Metodologji vlerësimi për kompensim</p>	<p>Kompensimi për prnat dhe objektet e prekura duhet të jetë së paku i barabart me vlerën tregtare. Devaluimi zakonisht hiqet nga kompensimi (apo përfshihet nga devaluimi i vlerësimit të vlerës së çmimit tregtar). Ligji për shpronësim nuk përcakton konkretisht kompensim për kostot e çfarëdo kompensimi për regjistrim dhe taksave për transfer.</p>	<p>Kompensimi duhet të jetë i barabartë me koston e plotë të zhvendosjes pa devaluim.</p>	<p>NPRRSH/PESR do të sigurohet që kompensimi do të jetë së paku i barabartë me vlerën për zhvendosje siç është përcaktuar në matricën e të drejtave të këtij dokumenti.</p>

Aspektet kryesore	Legjislacioni nacional	5KP-të e EBRD	Aksione për mbyllje të boshllëkut
Restaurim i ekzistencës	Ligji i Maqedonisë nuk kërkon ndihmë gjatë asnjë lloji të zhvendosjes apo masa për ndihmë për ekzistencë sikur zhvillimi i shkathtësive alternative për të fituar të ardhura apo sigurim të kredive të favorshme ose të mundësive për punësim.	5 KP-të e EBRD përfshijnë kërkesa për rikthim të ekzistencës për të rikthyer të ardhura dhe standardin e jetës për personat e zhvendosur në nivelet para projektit (edhe për personat me të drejta formale edhe për ata me joformale). Sigurimi i kompensimit për kulturat vjetore të prekura apo dëmtimet mbi shfrytëzuesit e tokave të prekura të cilët mund të mos jenë pronarë, duke përfshirë shfrytëzuesit joformal të cilët nuk do të jenë të autorizuar për atë në pajtim me legjislacionin nacional	NPRRSH për rikthim të ekzistencës si pjesë e zbatimit të PBT/LAP do t'i zbaton masat në vijim: <ul style="list-style-type: none"> Asistencë për identifikim të qasjes në të ardhura tjera/aktivitete për gjenerim të ekzistencës me Agjencinë për punësim në zonën e projektit Për ata ekzistenca e të cilëve shumë varet nga toka, NPRRSH do të organizon dhe do të këshillojë këshilla për kultivim të bletëve, afarizëm në nivel të vogël: bletari, tregti e vogël dhe/ose metoda efikase për blegtori për të lehtësuar rrjedha alternative të të ardhurave. Qasje për mundësi punësimi të krijuara nga Projekti (p. dhe. gjatë ndërtimit).
Data e fundit	Nuk ka përcaktim konkret të datës së fundit për të vërtetuar plotësim të kushteve për kompensim.	EBRD kërkon që data e fundit të parandalohet kërkesa oportuniste. Regjistrimi i popullatës do të identifikojë personat të cilët do të jenë të prekur nga projekti, do të përcakton kush i plotëson kushtet për kompensim dhe ndihmë dhe nëpërmjet përcaktimit të datës së fundit, do të dekurajon rritjen e numrit të personave të cilët janë përshtatshëm për këto beneficione (sikur banorë oportunistë).	Data e përfundimit të regjistrimit të popullatës dhe inventarit do të paraqet datë të fundit për përshtatshmëri. Informata lidhur me datën e fundit do të dokumentohen në mënyrë përkatëse dhe do të shpërndahen nëpër zonën e projektit.
Persona dhe grupe të lëndueshme	Ligji i Maqedonisë nuk përcakton masa specifike lidhur me grupe të lëndueshme. Qendra komunale për ndihmë	Disa PNP/PAP mund të konsiderohen si më të lëndueshëm se sa pjesa dërmuese e popullatës së prekur dhe, nëse janë të prekur nga Projekti, do të nevojitet zbatim i rikthimit të ekzistencës dhe/ose masave për	Gjatë regjistrimit të popullatës dhe hulumtimit socio-ekonomik, NPRRSH/PESR do t'i identifikojë PNP/PAP- të lëndueshëm, duke përfshirë gra në moshë dhe të angazhohet me ato dhe grupe tjera të lëndueshme nëpërmjet diskutimeve me grupe fokus.

Aspektet kryesore	Legjislacioni nacional	5KP-të e EBRD	Aksione për mbyllje të boshllëkut
	<p>sociale mund të ofrojë ndihmë, sipas Ligjit për ndihmë sociale. Ky ligj mundëson dhënie të pagesave për ndihmë dhe shërbime sociale për persona të lëndueshëm, siç është përcaktuar me ligj. Një prej kompensimeve në dispozicion për ndihmë sociale sipas ligjit është pagesë e njëfishtë financiare për ata të cilët e gjejnë veten në situatë të nevojës së papritur apo të përkohshme, duke përfshirë nevojën për akomodim.</p> <p>Asistenca nga punonjësit social mund të shfrytëzohet për t'i adresuar nevojat e personave me pengesa, familjet me një kryefamiljar, familje me të ardhura të ulëta, etj.</p> <p>Republika e Maqedonisë së Veriut gjithashtu ka një sërë ligjesh me të cilat personat e prekur mund të ndihmohen për të përmirësuar standardin e tyre jetësor (p. sh. qasje në</p>	<p>ndihmë. Grupe të tilla mund të përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ shfrytëzuesit joformal të tokave të prekura të cilët nuk kanë burime të të ardhurave ose prona të tyre; ▪ pronarë të objekteve joformale (të ndërtuara pa leje ndërtimi), pa prona tjera apo vend qëndrimi; ▪ personat të cilët varen nga toka e prekur që është toka e vetme që e posedojnë apo e përdorin; ▪ familjet me kryefamiljar më të moshuar, familje me vetëm një prind, etj, ▪ persona të cilët do të jenë të prekur nga zhvendosja fizike dhe/ose ekonomike, të cilët jetojnë në limitin nacional të varfërisë; ▪ personat analfabet të cilët mund të kenë vështirësi për qasje tek informatat lidhur me Projektin dhe blerje të tokës apo për t'i kuptuar kontratat dhe dokumentet tjera të rëndësishme, etj. 	<p>Mund të ketë raste kur individët janë në fakt pronarë, megjithatë, nuk kanë dokumentet përkatëse pronësie për të vërtetuar statusin e tyre të pronësisë dhe rrjedhimisht të nënshkruajnë marrëveshje për kompensim. Kjo mund të jetë rezultat i çështjeve sikur procedurat e papërfunduara të trashëgimisë apo marrëveshje të paregjistruarapër shitje/blerje. NPRRSH/PESR do të ofrojë ndihmë për t'i zgjidhur këto çështje.</p> <p>Asistencë për rivendosje do të përcaktohet në lidhje me nevojat specifike të personave të prekur. Asistenca do të sigurohet në bashkëpunim me Shërbimin komunal për punë sociale. Kjo ndihmë shumë shpesh u ofrohet familjeve të lëndueshme të cilat zhendosen fizikisht apo ekonomikisht nga ndonjë projekt dhe do të përfshijë këtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndihmë juridike ▪ Aty ku është e nevojshme, ndihmë për t'i marrë dokumentet personale, për të lehtësuar qasje në shërbimet e arritshme sipas legjislacionit nacional ▪ Asistencë për shfrytëzim të ndihmës sociale ▪ Asistencë për regjistrim të fëmijëve në shkollë dhe ndihmë për shfrytëzim të shërbimeve shëndetësore, etj.

Aspektet kryesore	Legjislacioni nacional	5KP-të e EBRD	Aksione për mbyllje të boshllëkut
	<p>shërbime shëndetësore, arsim, dokumentepersonale, banesa sociale, etj.) dhe këto ligjje mund të aplikohen ngaNPRRSH/PESR si bazë për zhvillim të mëtutjeshëm të programeve për rikthim të ekzistencës, veçanërisht për grupe të lëndueshme.</p> <p>Asistencë juridike mund të ofrohet për persona të lëndueshëm sipas Ligji për ndihmë juridike falas nga avokatë të caktuar nga Ministria për Drejtësi dhe shoqatat e zgjedhura të qytetarëve..</p>		
<p>Mekanizëm për ankesa</p>	<p>Legjislacioni nacional i përcakton të drejtat e qytetarëve të prekur (ata me të drejta formale)për të parashtruar ankesa në gjykata gjatë procesit të eksproprijimit, megjithatë nuk imponon përgatitje të mekanizmave konkret për ankesa.</p>	<p>Dispozitat e 5 KP-ve të EBRD kërkojnë të themelohet mekanizëm për ankesa në fazë sa më të hershme të procesit, që me kohë të pranohen dhe shqyrtohen çështjet lidhur me kompensimin dhe rivendosje të cilat janë shtruar nga personat e zhvendosur, duke përfshirë mekanizëm për mbështetje të dizajnuar për zgjidhje të kontesteve në mënyrë objektive. Publikim i përmbledhjes së ankesave dhe masave që janë ndërmarrë për zgjidhje të tyre në bazë të rregullt.</p>	<p>Nga NPRRSH-ja është themeluar mekanizëm për ankesa për Projektin, megjithatë nuk janë pranuar shumë ankesa deri më sot meqë aktivitetet për pastrim të tokës dhe ndërtimore ende nuk kanë filluar.</p> <p>Parashihet që NPRRSH/PESR dhe Realizuesi(t) të kenë punuar së bashku për t'u siguruar që PKR iNPRRSH-së dhe personi Përgjegjës i Komunitetit të Realizuesit do të punojnë së bashku për të punuar së bashku në shqyrtimin e ankesave lidhur me blerjen e tokës dhe rivendosjes.</p>

Aspektet kryesore	Legjislacioni nacional	5KP-të e EBRD	Aksione për mbyllje të boshllëkut
<p>Qasje në pronë /tokë para kompensimit</p>	<p>Sipas Ligjit për shpronësim dhe Ligjit për ndërtim qasje në tokë mund t'i jepet Kontraktuesit para pagesës së kompensimit.</p>	<p>EBRD-ja kërkon qasja në vend të lejohet pas pagesës së kompensimit.</p>	<p>NPRRSH/PESR do të përkushtohet që asnjë pronë të mos hapet apo preket në rastet kur ende nuk është arritur marrëveshje.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Procesi në vijim propozohet për raste kur prona do të hapet nga Kontraktuesi pasi të jetë arritur marrëveshje për kompensim por para se të jetë paguar kompensimi: • Shuma e synuar si kompensim do të vendoset në llogari kursimi dhe kopje e transferit të atillë do të sigurohet për pronarin e pronës; • Në rast se toka/pjesë e tokës është e dëmtuar, do të sigurohet kompensim shtesë dhe do të jepet për të mbuluar këtë dëmtim. • NPRRSH-ja do ta ndjekë legjislacionin nacional në rastet kur janë të penalizuar për vonesë të pagesës së kompensimit, pasi sipas Bankës Popullore të Maqedonisë së Veriut, kjo shumë e dënimit do t'i paguhet pronarit të pronës krahas shumës së kompensimit që i takon atij/asaj; • Asistencë tjetër do të sigurohet dhe do të përcaktohet në bazë të rasteve veçmas. ▪ NPRRSH/PESR prej së afërmi punon së bashku me institucionet kompetente relevante për proces të shpronësimit për t'u siguruar që gjithë kompensimet të paguhet në afat prej 30 ditëve, siç është përcaktuar me ligj.

Aspektet kryesore	Legjislacioni nacional	5KP-të e EBRD	Aksione për mbyllje të boshllëkut
Monitorim dhevaluim	Nuk ka kërkesa për monitorim dhe evaluim të rivendosjes dhe procesit dhe rezultateve të rikthimit të ekzistencës.β	Monitorim i procesit për rivendosje dhe rikthim të ekzistencës do të zbatohet në pajtim me KP 1 dhe duhet të përfshijë pjesëmarrje të faktorëve kyç sikur komunitetet e prekura. Raporti për përfundim duhet të ndërmerret pasi të jenë përmbushur të gjitha inputet në proces, duke përfshirë çdo nismë zhvillimore. Raporti mund t'i identifikojë veprimet e mëtutjeshme që do të plotësohen nga klienti.	<p>NPRRSH/PESR do të vendosin procedurë për monitorim dhe do të vlerësojnë zbatimin e tyre të KBT-së dhe PBT/LAP -së. Të gjitha transaksionet për të realizuar të drejtat tokësore, si dhe masat për komensim, aktivitetet për rivendosje dhe ndihma për rivendosje do të regjistrohen në PBT/LAP -në.</p> <p>NPRRSH/PESR do të punojë së bashku me Njësinë për Zbatim të Projektit (NJZP) që do të themelohet për të ndihmuar në zbatimin e projektit si pjesë e përgjegjësive të tyre, për të përkrahur përgatitjen e PBT/LAP dhe monitorim të zbatimit të dispozitave relevante të KBT-së.</p> <p>Pas realizimit të procesit për blerje të tokës, do të zbatohet revizion për realizim nga këshilldhënës të pavarur për t'u verifikuar që procesi është zbatuar në pajtim me PBT/LAP dhe 5 kriteret për Performans të EBRD.</p>

4 PARIME, OBJEKTIVA DHE PROCEDURA

4.1 OBJEKTIVAT

4.1.1. **Objektivat** e kësaj Kornize janë si në vijim:

- Të shmanget apo minimizohet zhvendosja jovullnetare (duke përfshirë atë fizike dhe ekonomike).
- Të merren parasysh alternativa të realizueshme në dizajnet e projektit për t'u shmangur apo së paku të minimizohet zhvendosja, derisa balansohen kostot dhe përfitimet mjedisore, sociale dhe financiare.
- Është konfirmuar që zhvendosja e familjeve rome është e pashmangshme, NPRRSH/PESR do të ndihmon për zgjidhje të çështjes së tyre për banim social dhe beneficinet tjera për të cilat kanë të drejtë, sa u përket Ligjeve nacionale të përmendura më sipër si dhe të përmirësohet ekzistenca standardi i tyre jetësor.
- Zbutje e impakteve negative sociale dhe ekonomike nga blerja e tokës apo ndalesat ndaj personave për shfrytëzim apo qasje në parcelat.
- Të sigurohet kompensim për humbje të pronave të prekura me kosto zëvendësimi (duke përfshirë prodhimet sezonale të kultivuara për konsum personal)

4.2 PARIME

4.2.1. **Parimet** që e përbëjnë këtë Kornizë janë si në vijim dhe do të respektohen gjatë zbatimit të Projektit:

- Blerja e tokës do të zbatohet në pajtim me **legjislacionin në fuqi në Maqedoninë e Veriut** (siç është përshkruar sipër), **Politika Mjedisore dhe Sociale 2014 e EBRD dhe 5 Kriteret e saj për Performans** (Blerja e tokës, Zhvendosja Jovullnetare dhe Zhvendosja Ekonomike), kjo Kornizë (**KBT/LAF**) dhe praktika e mirë ndërkombëtare si dhe çdo boshllëk do të shqyrtohen në mënyrë përkatëse, për ta përmbushur këtë parim;
- **Të gjithë personat e prekur (duke përfshirë grupet dhe individët e lëndueshëm, duke i përfshirë familjet rome) do të jenë të informuar dhe të konsultuargjatë** përgatitjes dhe zbatimit të Projektit për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të hershme dhe të informuar në proceset vendimmarrësve lidhur e zhvendosjen e tyre potenciale fizike. Njëjtë, pronarët lokal të tokave dhe banorët lokal do të konsultohen për t'u siguruar që e kuptojnë procesin e blerjes së tokës dhe të drejtat e tyre, ashtu siç aplikohet. Të dyja llojet e konsultimeve do të zbatohen në pajtim me dispozitat e theksuara në PMS-në dhe mundësojnë konsultime të synuara me grupet e lëndueshme dhe me potencial të marginalizohen;
- **NPRRSH/PESR do të zhvillon plan të zhvillon plan të detajuar për blerje të tokës (PBT/LAP) në pajtim me 5 PR-të** për Projektin që do të mbulon blerje të tokës, zhvendosje fizike (ku është e pashmangshme) dhe zhvendosje ekonomike për shkak të ndryshimeve në shfrytëzimin e tokës dhe qasje në resurset. Informata dhe kërkesat e përfshira në Planin e ardhshëm do të jenë lëndë e shpalljeve dhe konsultimeve publike. Plan i tillë do të bazohet në informata dhe të dhëna të sigurta të përditësuara (të grumbulluara gjatë regjistrimit të popullatës dhe vëzhgimit të inventarit të mjeteve) dhe do të përmban

informata themselfore për Projektin, impaktete e Projektit, personave dhe mjeteve të prekura, të drejta për të gjitha kategoritë e personave të prekur si dhe çdo çështje ligjore lidhur me blerjen e tokës dhe zhvendosje apo çdo zbrazëtimë ndërmjet ligjit vendas dhe 5 KP-ve. Plani gjithashtu do të përmban buxhet të detajuar dhe Tabelë kohore;

- **Regjistrim i popullatës dhe hulumtim i inventarit të mjeteve** për PBT/LAP do të identifikon edhe pronarët formal edhe joformal të tokave dhe shfrytëzuesit e tokave, duke përfshirë persona/familje të lëndueshme, sikur romët dhe pakicat tjera etnike, nëna që janë prind të vetëm, vejushe dhe vejan, persona me pengesa, persona të moshuar që jetojnë vetëm apo ata që jetojnë në varfëri ekstreme. Hulumtimi do të ndihmon për të identifikuar personat e prekur, duke i përfshirë ata të cilët nuk kanë të drejtën e njohur apo deklarim për tokën që e shfrytëzojnë;
- **Data e fundit për vërtetim të përshtatshmërisë** (edhe për pronarët/shfrytëzuesit formal dhe joformal të tokës) do të jetë data kur të jetë realizuar regjistrimi i popullatës dhe anketës për regjistrim të inventarit dhe ajo datë do të bëhet publike në të gjitha gjuhët nëpër afishet në zonën lokale (në objektet komunale, tabelat e komunës dhe zyrat e komuniteteve lokale etj), si dhe do të shpërndahet në publik, duke përfshirë në takime konsultimesh në komunitetet e synuara të prekura. Personat të cilët janë vendosur në zonën e Projektit pas datës së fundit nuk do të mund të marrin asnjë kompensim;
- **Të gjithë pronarët, drejtuesit/qiramarrësit dhe shfrytëzuesit** strukturave dhe parcelave të përfshira në kohën e datës së fundit, qofshin me ose pa të drejta dhe deklarata plotësisht të njohura ligjore, **janë të përshtatshëm për kompensim dhe/ose** Ndhimë, siç është theksuar në Matricën për të drejtamë poshtë;
- **Aktivitete lidhur me ndërtim** do të organizohen për të shmangur dhe minimizuar zhvendosje ekonomike, p. sh. të sigurohet që rrugët për hyrje nuk bllokohen nga fshatarët dhe shërbimet tjera (p.sh. A&E shërbimet) mund të kenë qasje të pakufizuar dhe (aty ku mundet) tokat dhe aktivitetet bujqësore gjatë periudhave të vjeljes nuk të mos jenë të ndaluara;St;
- **Standarde jetësore dhe/ose ekzistencat e personave të prekur** do të kthehen, në periudhë sa më të shkurtë të mundur;
- **Bazuar në Ligjin nacional dhe praktikën më të mirë, vlerësimi zyrtari** parcelave të tokave/pronave të prekura/përmirësimi në tokat do të zbatohet nga ekspertë të certifikuar të cilët do të sigurojnë që amortizimi nuk përfshihet;
- Kompensimi do të sigurohet para zhvendosjes apo vendosjes së restriksioneve për qasje. Çështjet lidhur me **pagesat e kompensimit me para (me kosto të plotë zëvendësimi) do të diskutohen dhe dakordësohen me pronarë dhe të gjithë anëtarët e prekur të familjeve. Të gjitha kompensimet dhe asistencat për kthim të ekzistencës do të sigurohen në mënyrë të barabartë për meshkujt dhe gratë;**
- **NPRRSH/PESR do të sigurohet që nuk do të mbyllet apo punohet asnjë pronë për të cilën ende nuk është arritur marrëveshje.** Procesi në vijim është sugjeruar aty ku do të ketë punime nga Kontraktuesi pasi të jetë arritur marrëveshje për kompensim por para se të kompensimi;
- Shuma e synuar si kompensim do të transferohet në llogari kursimi dhe kopje e transferit të tillë sigurohet për pronarin e pronës;
- Në rast se ajo tokë /parcelë është e dëmtuar, do të dakordësohet dhe do të sigurohet kompensim shtesë për të mbuluar këtë dëmtim;

- NPRRSH/PESR do të referohet në dispozitat penale të legjislacionit nacional për vonesë të pagesës së kompensimit, pasi sipas Bankës Popullore të Maqedonisë së Veriut, ky dënim i paguhet pronarit të pronës krahas shumëve të kompensimit që i takon atij/asaj;
- Asistenca tjera do të sigurohen dhe do të përcaktohen në bazë të rasteve veçmas;
- NPRRSH/PESR nga afër do të punon së bashku me institucionet kompetente relevante për proces të eskproprijimit për t'u siguruar që gjithë kompensimet të paguhen në afat prej 30 ditëve, siç është përcaktuar me ligj;
- **Leje për lëvizje do të përcaktohet për ata të cilët mund të jenë të subjekt i zhvendosjes fizike. Shuma të barabarta të pagesës për leje për lëvizje do të sigurohen veçmas përmeshkujt dhe gratë e ndikuar. PBT/LAP -ja do të përcakton dhe do të publikon lejet specifike për lëvizje si dhe përkrahje për grupet e tilla (bazuar mbi të dhënat socio-ekonomike që do të grumbullohen gjatë hulumtimit për numër të popullatës);**
- **Personat dhe komunitetet e prekura nga Projektido të pranojnë dhe informata dhe do të jenë të konsultuar me qëllim të lehtësohet pjesëmarrje e tyre e hershme dhe e informuar në procesin e vendimmarrjes lidhur me blerjen e tokës dhe rikthimin e ekzistencës. Qasja tek informatat dhe ndihmë për personat/familjet e lëndueshme do të lehtësohen nga NPRRSH/PESR sipas rasteve ku PNP/PAP shqyrtohen për të identifikuar nëse janë të përshtatshëm për mirëqenie sociale përkatëse;**
- **Mekanizmi ekzistues për ankesa do të fuqizohet dhe do të përshtatet për të pranuar dhe shqyrtuar me kohë të gjitha çështjet e përgjithshme dhe specifike për kompensim dhe kthim të ekzistencës që janë parashtruar nga PNP/PAP;**
- NPRRSH/PESR do të **monitoron zbatimin e blerjes së tokës, të gjitha llojet zhvendosjes dhe kthim të ekzistencës** nëpërmjet rregullimeve të brendshme institucionale si dhe nëpërmjet monitorimit të pavarur të jashtëm. Masa korigjuese do të ndërmerren sipas nevojës. Të gjitha transaksionet dhe akvitetet në lidhje me blerjen e tokës, si dhe masat për kompensim, aktivitetet për rilokim dhe ndihma për zhvendosje do të dokumentohen.

4.3 BLERJA E TOKËS, PROCESI I ZHVENDOSJES DHE KTHIMIT TË EKZISTENCËS

4.3.1. Zbatimi i procesit të blerjes së tokës dhe planifikimit të kompensimit është dizajnuar në bazë të legjislacionit nacional dhe për plotësim të kritereve të EBRD. Hapat kryesor të procesit janë të përmbledhur më poshtë:

Tabela4-1 – Listaeaktiviteteteve që do të ndërmerren

Hapat kyç	Aktivite qe do të ndërmerren nga Projekti	Statusi aktual
Regjistrim i popullatës dhe inventarit Hulumtim socio-ekonomik.	Për plotësim të kushteve për 5 KP të EBRD, NPRRSH/PESR do të organizojë hulumtim në zonën e projektit për të identifikuar të gjitha palët që mund të jenë prekur. Persona fizikisht të zhvendosur: Grumbullim i të dhënave për këtë grup të njerëzve nëpërmjet angazhimit të	Do të zbatohen vëzhgime pas publikimit të KBT-së

Hapat kyç	Aktivite të ndërmërrë nga Projekti	Statusi aktual
	<p>drejtpërdrejtë. Të dhënat gjithashtu do të përdoren nga NPRRSH/PESR për t'i përgatitur masat e propozuara për rikthim të ekzistencës në këtë dokument dhe për të mbështetur monitorimin e procesit të blerjes së tokës dhe të rikthimit të ekzistencës.</p> <p>PNP/PAP/Familje ekonomike të zhvendosur: PNP/PAP toka e të cilëve blihet do të ftohen në takime për konsultim me NPRRSH-në dhe organet komunale, gjatë të cilëve NPRRSH-ja do të zbaton hulumtim për grumbullim të të dhënave socio-ekonomike. Qëllimi i ndërmarrjes së këtyre hulumtimeve është të grumbullohen të dhënat kryesore socio-ekonomike për PNP/PAP me qëllim të identifikimit të nevojave specifike të PNP/PAP individual dhe çdo lëndueshmëri për të cilat mund të nevojitet përkrahje shtesë për të rivendosur ekzistencat e tyre për shkak të humbjes së tokave të tyre; të dhënat gjithashtu do të përdoren për të ndihmuar NPRRSH-në në detajizim të mëtutjeshëm të ndihmës së propozuar të përfshirë në këtë dokument dhe të përdoren për të mbështetur monitorim të programit për blerje të tokës dhe rikthim të ekzistencës.</p>	
Përcaktimet e shtesë të fundit për plotësim të kushteve	Për qëllimet e këtij projekti, data e fundit do të verifikon plotësimin e kushteve do të jetë data kur të gjitha hulumtimet (shih më lartë) të jenë kompletuar. Data e fundit do të publikohet dhe do të shpërndahet në publik paraprakisht (në gjuhët e të gjitha bashkësive etnike në vend), gjatë takimeve për konsultim në komunitetet e prekura në fjalë	Të zbatohen gjatë konsultimeve me PNP/PAP. NPRRSH/PESR do të sigurohet që data e fundit për plotësim të kushteve do t'u sqarohet PNP/PAP dhe do të bëhet publike.
Identifikim i Personave/Familjeve të lëndueshme.	Gjatë hulumtimeve (si më sipër), NPRRSH/PESR do të bën identifikim paraprak të PNP/PAP me qëllim të përcaktohet përkrahje shtesë që mund t'u ofrohet dhe të dokumentohet në PBT/LAP që do të përgatitet nga NPRRSH. Aty ku është e nevojshme, NPRRSH/PESR do të menaxhon me organet për punë sociale për këtë çështje kur përcaktohet kompensimi dhe masat për rikthim të ekzistencës dhe kur kërkohet inkuadrimi i tyre në proces (sa u përket këtyre	Të zbatohet gjatë hulumtimeve

Hapat kyç	Aktivite të ndërmërrën nga Projekti	Statusi aktual
	autoriteteve përgjegjëse në lidhje me të gjitha kategoritë e PNP/PAP të lëndueshme). Ky hap do të mundësojë NPRRSH/PESR të identifikon nevojat dhe lëndueshmëritë specifike për të informuar rivendosje shtesë dhe përkrahje të rikthimit të ekzistencës që mund të jetë e nevojshme të kërkohet.	
Vendosje të Mekanizmit të gjerë për ankesa përshqyrtim të gjitha hulumtimeve dhe çështjet lidhur me projektin	NPRRSH/PESR veç më ka Mekanizëm për Ankesa (MA) dhe për këtë hap, do ta revidon për t'u siguruar që ka mjete të mjaftueshme në dispozicion për të shqyrtuar hulumtimet dhe komentet që vijnë, për t'i regjistruar ato dhe për të raportuar për kërkesat e Mekanizmit të Ankesave të EBRD (Udhëzues të Mekanizmit të Ankesave, Kapitulli 3.1 dhe 3.2, https://www.ebrd.com/downloads/about/sustainability/grievance-mechanism.pdf)	NPRRSH/PESR për kontrollim të resurseve të mjaftueshme në dispozicion për të mbështetur procesin ekzistues të MA-së
Konsultime me PNP/PAP e identifikuar për t'i diskutuar çështjet e identifikuar gjatë regjistrimit të popullatës dhe të inventarit si dhe nëpërmjet MA-së	NPRRSH/PESR do të udhëheqë angazhimin e faktorëve me PNP/PAP-në, siç është përkufizuar në këtë KBT dhe PMS-në e Projektit.	Të zbatohet në bazë permanente dhe në pikat kryesore të Projektit
Përgatitje e Planit të detajuar për Blerje të Tokës (PBT/LAP) dhe publikimin e të njëjtit	Në bazë të kësaj Kornize dhe para çdo punimi ndërtimor dhe pas plotësimit të hulumtimeve, NPRRSH/PESR do të përgatitë dhe do të publikojë PBT/LAP për Projektin.	Të zbatohet para ndërtimit dhe pas plotësimit të Dizajnit të detajuar

5 RASTE TË VEÇANTA

- 5.1.1. Gjatë vizitave të vendeve është theksuar që disa persona që mund të jenë prekur do të jenë në kategorinë e personave të lëndueshëm Përveç kësaj, është shënuar që numër i caktuar i pronave (banesore dhe jobanesore) mund të vendosen në tampon zonë sigurie prej 40 metrave. Në bazë të studimeve, janë propozuar masat e përcaktuara më poshtë.

5.2 PRONA QË GJENDEN NË TAMPON ZONËN E SIGURISË PREJ 40METRAVE

- 5.2.1. NPRRSH/PESR e ka të qartë rëndësinë e tampon zonës së sigurisë dhe gjatë përfundimit të rutës/trasesë, me kujdes do të merr parasysh planin e kërkuar për ndërtim të rrugës, si dhe planin e rrugëve për hyrje, instalimet e kablove dhe gypave (që mund të nevojiten). Gjerësia e tampon zonës së sigurisë do të luan rol kyç në përcaktimin e numrit të saktë të shtëpive që do të vendosen në zonë të tillë dhe së këtejmi numër të **PNP/PAP**. NPRRSH/PESR do të sigurohet që duke e pasur parasysh në veçanti dizajnin, trasenë/rutën e rrugës dhe planin e projektit, do të shmangin apo minimizojnë zhvendosje ekonomike ose fizike të banorëve lokal.
- 5.2.2. Duhet të theksohet që shumica (nëse jo edhe të gjithë) e këtyre shtëpive janë mbase ndërtime legale, p. sh. janë ndërtuar në bazë të lejeve ligjore për ndërtim që përgjithësisht u jepen personave sapo të blejnë parcelën apo parcelat e tokës në fjalë.
- 5.2.3. Duke pasur parasysh çfarë do ndërtimi të ardhshëm të pronave në tampon zonën, NPRRSH/PESR do ta zbatojë legjislacionin në fuqi me çka parandalohet ndërtim i pronave për ndërtim në zonën e projektit dhe në suaza të tampon zonës prej 40metrave. NPRRSH-ja gjithashtu qartë do t'u bën me dije komuniteteve lokale që ata të cilët pas datës së fundit vazhdojnë të ndërtojnë prona të reja në tampon zonën prej 40metrave, nuk do të kenë të drejtë për kompensim.

5.3 GRUPE TË LËNDUESHME

- 5.3.1. Disa individë apo grupe janë më të lëndueshëm se sa shumica e popullatës së prekur dhe nëse janë të ndikuar nga Projekti, si rezultat i kësaj do të nevojitet zbatim i masave të veçanta për kthim të ekzistencës dhe/ose ndihmë. Grupet e tilla mund të përfshijnë:
- Familje rome që mund të jenë subjekt i zhvendosjes fizike;
 - Pronarët e strukturave (të ndërtuara pa lejet e nevojshme), pa pronë tjetër apo vend për banim;
 - Persona të cilët varen nga të ardhurat/ekzistenca prej tokës në fjalë dhe ajo është toka e vetme që e posedojnë apo shfrytëzojnë;
 - Familje me kryefamiljar të moshuar, familje me vetëm një prind, familje shumëanëtarëshe, ose ato që jetojnë nën kufirin e varfërisë;
 - Persona të cilët do të jenë të prekur nga zhvendosja fizike dhe/ose ekonomike, statusi socio-ekonomik i të cilëve është ulët, për shembull shfrytëzues të ndihmës sociale;
 - Persona analfabet të cilët mund të kenë vështirësi të thirren në informatat për Projektin dhe blerjen e tokave si dhe për t'i kuptuar marrëveshjet dhe dokumentet tjera të rëndësishme, etj.

- 5.3.2. Shkalla e lëndueshmërisë do të vlerësohet dhe përcaktohet në bazë të rezultateve nga regjistrimi i popullatës dhe anketa për regjistrim të inventarit në zonën e projektit dhe mbikëqyrje socio-ekonomike që mund të zbatohet nga NPRRSH/PESR gjatë konsultimeve me pronarët e tokave dhe më saktë të përkufizuara në PBT/LAP e ardhshme.

6 KUALIFIKIMI DHE E DREJTA

6.1 KUALIFIKIMI PËR NDIHMË PËR KTHIM TË EKZISTENCËS

- 6.1.1. Ky Seksion përmban Matricë të të drejtave të cilat i identifikojnë kategoritë e personave të prekur dhe masat për kompensim për të cilat kanë të drejtë. Matrica është kalimtare për shkak se i identifikon të gjitha skenaret dhe grupet e mundshme të personave të prekur, ndërsa PBT/LAP -ja detajore e ardhshme do të përmban Matricë të të Drejtave të rafinuar dhe të thurur për pasqyrim të kategorive të personave të prekur, që janë identifikuar gjatë regjistrimit të popullatës dhe vëzhgimit për regjistrim të inventarit. Matrica e paraqitur më poshtë përmban të drejta në pajtim me 5 KP të EBRD. Matrica e të drejtave gjithashtu i identifikon humbjet ekonomike dhe impaketet e Projektit mbi ekzistencë. Këto humbje përfshijnë humbje potenciale të tokës bujqësore dhe çdo humbje të të ardhurave si rezultat i Projektit.
- 6.1.2. Masat e propozuara për kompensim do të mbulojnë ndihmën për zhvendosje (ku zhvendosja fizike është e pashmangshme), kompensime për harxhimet e transaksioneve dhe këshilla për tregtarë të vegjël kultivues të bletëve për të kthyer ekzistencën si burim alternativ i të ardhurave. Plotësimi i kushteve për kompensim dotë përcaktohet në bazë të të dhënave nga regjistrimi i popullatës dhe regjistrimit të inventarit. Të dhënat nga përfundimi i regjistrimit do të shërbejnë si datë e fundit për plotësim të kushteve, megjithatë, personat me vërtetimet formale të pranuar juridikisht do të kenë mundësinë për të fituar kompensim pas datës së fundit.
- 6.1.3. NPRRSH/PESR do të punon me autoritetet për të ndihmuar personat e prekur nga projekti duke vlerësuar burime alternative për përkrahje para fillimit të punimeve ndërtimore. NPRRSH/PESR gjithashtu do të siguron qasje tek informatat e lidhura me projektin dhe mundësitë për punësim në projekt, si dhe lehtësim të të qasjes tek informatat nga Agjencia për punësim.

6.2 MATRICA E TË DREJTAVE

Tabela6-1 – Matrica e të drejtave

Impakti	Kategoria e PNP/PAP	Të drejtat
FAZA PARA-NDËRTIMORE, ESKPROPRIJIMI PËRHERSHËM I TOKËS		
Humbje e tokës (kryesisht pyje dhe/ose tokë bujqësore, kullosa, si dhe plantacione ose pjesë të parcelave për qëndrim).	Pronarë të tokave–pronarë formal me të drejta dhe autorizime ligjore mbi tokën)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kompensim me para me kosto të plotë për zhvendosje apo zëvendësim të tokës në bazë të ngjashme. ▪ Të gjitha harxhimet për transaksionet (duke përfshirë harxhime noterie, taksa regjistrimi dhe taksa vlerësimi) gjithashtu do të kompensohen me shumën. ▪ E drejta për të korrjen e kulturave ekzistuese. ▪ Kompensim për çdo pronë të dëmtuar me harxhimet për zhvendosje. ▪ Këta persona gjithashtu do të jenë të kompensuar (me kesh) për instalim të shfrytëzuar për prodhimtari bujqësore që nuk mund të lëvizet nga toka dhe për kulturat dhe drunjtë e prekura ▪ Të gjitha kompensimet do të sigurohen me koston për zhvendosje, pa heqje për devalvim (në bazë të raportit dhe përlllogaritjeve të vlerësuesit).
	Shfrytëzues formal të tokës (p. sh. qiramarrës me të drejtë ligjore formale)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Konsultime dhe sigurim të informatat për blerje të tokës dhe së paku dy muaj paraprakisht të hyrjes në parcelë për të mundësuar qiramarrësit të gjejnë tokë tjetër për qiramarrje. ▪ Nëse gjatë hulumtimit konstatohet që PNP/PAP-ja është i lëndueshëm, atëher NPRRSH/PESR do të kërkojë përkrahje shtesë nga Komuna për të gjetur parcelë tjetër për ta marrë me qira formalisht dhe për të siguruar qasje në shërbimet infrastrukture (furnizim me ujë, etj).
	Pronarë të tokave–pronarë formal me të drejta dhe autorizime ligjore mbi tokën)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kompensim me para me kosto të plotë për zhvendosje apo zëvendësim të tokës në bazë të ngjashme. ▪ Të gjitha harxhimet për transaksionet (duke përfshirë harxhime noterie, taksa

Impakti	Kategoria e PNP/PAP	Të drejtat
		<p>regjistrimi dhe taksa vlerësimi) gjithashtu do të kompensohen me shumën.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ E drejta për të korrjen e kulturave ekzistuese. ▪ Kompensim për çdo pronë të dëmtuar me harxhimet për zhvendosje. ▪ Këta persona gjithashtu do të jenë të kompensuar (me kesh) për instalim të shfrytëzuar për prodhimtari bujqësore që nuk mund të lëvizet nga toka dhe për kulturat dhe drunjat e prekura ▪ Të gjitha kompensimet do të sigurohen me koston për zhvendosje, pa heqje për devalvim (në bazë të raportit dhe përlllogaritjeve të vlerësuesit).
Tokë Jetime: p. sh. pjesë e parcelës së prekur të tokës që nuk është e shfrytëzueshme ekonomikisht pasi pjesa më e madhe e saj është bërë subjekt eksproprijimi.	Pronarë të tokave (formal me të drejta dhe autorizime ligjore mbi tokën)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nëse ndonjë kërkesë e pronarit të prekur të tokës është bërë në pajtim me Ligjin për eksproprijim (Neni 20) dhe është pohuar se është kërkesë e arsyeshme ë bazë të raportit vlerësues të ekspertëve, PNP/PAP-i do të merr kompensim kesh me koston e plotë të zëvendësimit apo zëvendësim me tokë në bazë të ngjashme.
Humbje e kulturave vjetore/kultura shumëvjetore dhe drunjë, duke përfshirëpemore.	Pronarë të kulturave dhe drunjve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ NPRRSH/PESR do t'i lejojë PNP/PAP-it, aty ku është e mundur, të korrë kulturat. Aty ku janë humbur, kompensim me para për kulturat/bimët e humbura vjetore dhe shumëvjetore me kosto të plotë zëvendësimi.
Humbje e objekteve që nuk janë për banim (p. sh. baraka, ahur, gardhe, sisteme për ujitje etj.)	Pronarë të objekteve dhe infrastrukturave të pabanuara (edhe formale edhe informale)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kompensim me para me kosto të plotë zëvendësimi dhe ▪ Leje për lëvizje për prona të lëvizshme ose ndihmë për t'i lëvizur ato.
Humbje e objekteve për banim	Pronarë të objekteve/shtëpive për banim	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kompensim me para me kosto të plotë zëvendësimi ose zëvendësim me shtëpi me bazë të ngjashme. ▪ Të gjitha harxhimet transaksionale (duke përfshirë taksa noterie, taksa për regjistrim dhe taksa për vlerësim) gjithashtu do të kompensohen me koston. ▪ Kompensim për çdo pronë të dëmtuar me kosto zëvendësimi. ▪ Asistencë për rivendosje, duke përfshirë leje për lëvizje ose ndihmë për lëvizje ▪ Të gjitha kompensimet do të sigurohen me kosto të plotë zëvendësimi, pa heqje për

Impakti	Kategoria e PNP/PAP	Të drejtat
		<p>devalvim (bazuar në raportin dhe përlogaritjet e vlerësuesit të pavarur).</p>
	Shfrytëzues formal (p. sh. qiramarrës) të objekteve/shtëpisë për banim	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sigurim i informatave për blerje të shtëpisë së paku tre muaj para rrënimit, për t'i mundësuar qiraxhinjtë të gjejnë akomodim tjetër ▪ Leje për lëvizje apo ndihmë për t'u zhvendosur
	Shfrytëzues informaltë objekteve/shtëpisë për banim	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sigurim i informatave për blerje të shtëpisë së paku tre muaj para rrënimit. ▪ Ndihmë për zhvendosje, duke përfshirë leje për lëvizje apo ndihmë për të lëvizur nëse shfrytëzuesi nuk ka vend tjetër për banim (ose hulumtimi e identifikon atë si të lëndueshëm) atëherë PNP/PAP-it do t'i sigurohet akomodim adekuat me siguri qiraje (p. sh. banesë social) për çka NPRRSH/PESR do të kërkon përkrahje nga Komuna dhe organet për ndihmë sociale.
Humbje permanente e burimeve të të ardhurave dhe/ose të ekzistencës lidhur me cilën do prej humbjeve të përmendura më sipër dhe veçanërisht Ekzistencë 'Bujqësore'	Pronari i tokës i cili nuk ka burime tjera të të ardhurave dhe varet vetëm nga aktiviteti formal dhe informal bujqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kompensim me kesh për rrjet të humbur të të ardhurave gjatë periudhës së tranzitimit dhe për vitin e ardhshëm për t'i mundësuar PNP/PAP-it të gjejë mënyrë alternative për t'i kthyer aktivitetet e tij/saj ekonomike ▪ Kosto e filizeve për sezonën e ardhshme ▪ Asistencë për rikthim të ekzistencës (shih më poshtë).
IMPAKTE GJATË NDËRTIMIT –IMPAKTE TË PËRKOHSHME		
Humbje e përkohshme e tokës– e nevojshme gjatë periudhës së ndërtimit p.sh. tokë e cila nevojitet për ndërtim vetëm si hyrje për ndërtim/ zona për depo/ komplekse/ ente shëndetësore).	Pronarë të tokave (formal me të drejta dhe autorizime ligjore mbi tokën)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kompensim me para me shumë të plotë për zëvendësim për të drejtën për shfrytëzim të tokës me kontratë/marrëveshje për periudhë të dakorduar – në bazë të vlerësimit të kompensimit nga vlerësues të certifikuar ▪ Kthim i tokës pas shfrytëzimit.
	Shfrytëzues formal të tokës (p. sh. qiramarrës me të drejtë formale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sigurim i informatave për blerje të tokës së paku dy muaj para hyrjes në truall për t'i mundësuar qiramarrësit të gjejë tokë tjetër me qira

Impakti	Kategoria e PNP/PAP	Të drejtat
	ligjore mbi tokën që e posedon/shfrytëzon)	<ul style="list-style-type: none"> Nëse gjatë hulumtimit është vendosur që PNP/PAP-i është i lëndueshëm, atëherëNPRRSH/PESR do të kërkon përkrahje shtesë nga Komuna apo tërësi tjera për të gjetur sipërfaqe tjetër tokësore me qira dhe për të siguruar qasje në shërbimet infrastrukturore (furnizim me ujë, etj).
	Shfrytëzues joformal të tokës (a të drejta apo autorizime formale ligjore mbi tokën që e përdorin – kjo gjithashtu mund të vlen për sipërfaqe të tokave shtetërore që janë përdorur në bazë të zakonshme	<ul style="list-style-type: none"> Konsultime dhe sigurim të informatave për impaktet e përkohshme në tokë dhe detaje për projektin së paku dy muaj para hyrjes në truall për t'i mundësuar shfrytëzuesit të gjen tokë tjetër.. Nëse gjatë hulumtimit është vendosur që PNP/PAP-i është i lëndueshëm, atëherëNPRRSH/PESR do të kërkon përkrahje shtesë nga Komuna apo tërësi tjera për të gjetur sipërfaqe tjetër tokësore me qira dhe për të siguruar qasje në shërbimet infrastrukturore (furnizim me ujë, etj). NPRRSH/PESR do të sigurojë ndihmë për të siguruar qira
Humbje e kulturave dhe drunjve vjetor/shumëvjetor, duke përfshirë në plantacionet pemore.	Pronarë të kulturave dhe drunjve	<ul style="list-style-type: none"> NPRRSH/PESR do t'i lejonPNP/PAP-it, aty ku janë humbur,kompensim me para për kulturat/bimët e humbura vjetore dhe shumëvjetore me kosto të plotë zëvendësimi.
Humbje e përkohshme e burimeve të të ardhurave dhe/ose për ekzistencë lidhur me cilën do prej humbjeve të mësipërme dhe veçanërisht Ekzistencat 'Bujqësore'	Pronar toke(shfrytëzues të cilët nuk kanë burime tjera të të ardhurave dhe varen vetëm nga aktiviteti formal apo joformal bujqësor)	<ul style="list-style-type: none"> Kompensim me kesh për rrjet të humbur të të ardhurave gjatë perudhës së tranzitimit dhe për vitin e ardhshëm (derisa të rivendosen aktivitetet afariste/ekonomike në lokacion tjetër) Asistencë për rikthim të ekzistencës (shih poshtë).
PNP/PAP TË LËNDUESHËM		
Çdo humbje/impakt tjetër specifik mbi grupet e	Grupe / individë të lëndueshëm	<ul style="list-style-type: none"> Masa të veçanta për pjesëmarrje efektive, kompensim rivendosje dhe rikthim të ekzistencës, do të përkufizohen në PBT/LAP për mbulim të grupeve të lëndueshme

Impakti	Kategoria e PNP/PAP	Të drejtat
lëndueshme, lidhur me blerjen e tokës për Projektin, të identifikuar gjatë hulumtimit dhe përgatitjes së PBT/LAP -së		që mund të jenë prekur, duke përfshirë: gra të moshuara, gratë dhe familjet rome.

6.3 NDIHMË PËR RIVENDOSJE DHE KTHIM TË EKZISTENCËS

6.3.1. **Ndihmë për rivendosje:** Asistenca për rivendosje do të përkufizohet në bazë të rezultateve nga regjistrimi i popullatës dhe i inventarit, në pajtim me nevojat specifike të personave të prekur. Kjo ndihmë shumë shpesh u ofrohet familjeve të lëndueshme të cilat janë fizikisht apo ekonomikisht të zhvendosura nga ndonjë projekt dhe mund të përfshijë këtë:

- Ndihmë për të lëvizur PNP/PAP në akomodim përkatës me siguri pronësie. Për shembull, familje e lëndueshme që nuk ka vendqëndrim tjetër, do të ndihmohet për t'u vendosur në banesë komunale sociale, me kontratë afatgjatë për të siguruar qëndrim.
- Ndihmë juridike
- Ndihmë për të marrë dokumente personale/pasaporta aty ku është e nevojshme, për të ndihmuar qasje në shërbimet në dispozicion sipas legjislacionit nacional
- Ndihmë për shfrytëzim të ndihmës sociale
- Ndihmë për regjistrim të fëmijëve në shkollë
- Ndihmë për qasje në shërbimet mjekësore, etj.

6.3.2. Asistenca për rivendosje gjithashtu përfshin dhënie të lejes për lëvizje për anëtarët e familjes dhe pronave të lëvizshme, apo ndihmë për t'i transferuar ato. Pronat e lëvizshme zakonisht përfshijnë mobilje, pajisje, sende personale, etj. Asistenca për rivendosje do të sigurohet për personat e identifikuar me nevojë gjatë regjistrimit të popullatës dhe pronave. NPRRSH-ja do të bashkëpunon me institucione dhe organizata që mund të sigurojnë ndihmë të mëtutjeshme, sikur qendra komunale për punë sociale apo organizatat lokale të cilat punojnë me grupe të lëndueshme për t'i ndihmuar ata në shfrytëzimin e shërbimeve përkatëse.

NDIHMË PËR RIKTHIM TË EKZISTENCËS

6.3.3. Aty ku zbatimi i projektit çon në humbje të përhershme të të ardhurave apo mjeteve për ekzistencë (zhvendosje ekonomike), përveç kompensimit për tokën dhe pronat e prekura, PNP/PAP do të kompensohet për humbjen e të ardhurave gjatë periudhës së tranzitit, NPRRSH/PESR do të zbaton masa për rikthim të ekzistencës sipas nevojës, që do të përkufizohen hollësisht në PBT/LAP. Megjithatë nuk parashihet të nevojitet gjerësisht në bazë të impakteve të parapara të Projektit, masat e tilla mund të përfshijnë:

- Qasje për mundësi për punësim të krijuara nga Projekti (p. sh. gjatë ndërtimeve dhe aktiviteteve – nëse PNP/PAP ka shkathtësi të përshtatshme);
- Kompensim për rivendosje të aktiviteteve afariste tjetërkund;
- këshilla për kultivim të bletave dhe për afaristë të vegjël të ofruara për të mundësuar qasje për PNP/PAP në të ardhura tjera/gjenerim të ekzistencës në zhvillimin e ardhshëm/të shkathtësive;
- Krijim i mundësive specifike për punë për PNP/PAP (roje sigurie, shërbime pastrimi, etj)
- Ndihmë për qasje në mjete kreditore;
- Kompensim për apo ndihmë për transferim të pajisjeve dhe makinierive.

6.3.4. Ndihmë për rikthim të ekzistencës do të ofrohet për ata mjetet kryesore të ekzistencës së të cilëve do të jenë të ndikuara nga projekti. NPRRSH/PESR do të bashkëpunon me institucionet dhe organizatat që mund të sigurojnë këtë ndihmë sikur Komuna, agjencitë për zhvillim bujqësor në atë zonë; dhënësit lokal të shërbimeve, etj.

7 ZBATIM I AKTIVITETEVE DHE MONITORIM I BLERJES SË TOKËS

7.1.1. Seksioninë vijim i paraqet aktivitetet që do të ndërmerren gjatë zbatimit të kësaj kornize.

7.2 REGJISTRIT I POPULLATËS DHE I INVENTARIT DHE HULUMTIM SOCIO-EKONOMIK

7.2.1. **Pasi të përcaktohen traseja dhe ruta**, NPRRSH/PESR do të përcakton specialistë, aty ku ka nevojë me ndihmë të punonjësve të tjerë të NPRRSH/PESR të zbaton regjistrim të popullatës dhe të inventarit si dhe hulumtim socio-ekonomik për të përfshirë të gjithë **PNP/PAP** të cilët do të jenë të prekur nga projekti. Nëse është konfirmuar që numri i përgjithshëm i këtyre individëve pritet të jetë mbi 100 persona, do të jetë efikase nëse ndonjë palë nga jashtë e zbaton atë hulumtim.

7.2.2. Bazë e të dhënave në eksel dokument do të formohet dhe rregullisht do të jetë e përditësuar me detaje demografike dhe socio-ekonomike për PNP/PAP, nga ana e ekipit E&S dhe Njësisë së ekipit për Blerje të Tokës në NPRRSH/PESR. Fundi i hulumtimit do të jetë datë e fundit, siç do të jetë marrëveshja ndërmjet NPRRSH/PESR dhe EBRD, pas së cilës cili do person që vendoset në zonën e projektit apo cila do shtëpi e re e ndërtuar në zonën prej 40 metrave nuk do të ketë të drejtë për kompensim dhe ndihmë për rikthim të ekzistencës. Data e fundit do të bëhet publike dhe implikimet nga e njëjta do të sqarohen nga NPRRSH/PESR për personat e prekur. Obligimi i NPRRSH/PESR do të jetë të punon me dhe të rikthejë ekzistencat e PNP/PAPromë që mund të jenë subjekt i zhvendosjes fizike, siç është përcaktuar në Matricën e të drejtave.

7.3 IDENTIFIKIM I SHËRBIMEVE TË LIRA DHE PROGRAME PËR PËRKRAHJE TË PNP/PAP TË LËNDUESHËM

7.3.1. Ekipi i NPRRSH/PESR E&S dhe Njësia e ekipit për Blerje të Tokës do të identifikojnë shërbime dhe programe për përkrahje që mund të shfrytëzohen për të ndihmuar PNP/PAP e lëndueshëm. Kjo do të përfshin programe dhe shërbime që implementohen nga numër më i madh i faktorëve në Komunën apo tërësi tjera. Ekipet do të mbajnë kontakte me departamentin e NPRRSH/PESR për punësim/RNJ për të siguruar që kur të shfaqen mundësi për punësim, atëherë PNP/PAP-i me shkathësitë e përshtatshme të jetë i informuar për mundësi të tilla dhe t'i ndihmojë të aplikojnë për ato.

7.3.2. NPRRSH/PESR do të minotoron progresin e secilit PNP/PAP të lëndueshëm dhe do të adapton ndihmën individuale të nevojshme përgjatë zbatimit të kësaj Kornize, derisa ekzistenca e plotë e PNP/PAP-it të lëndueshëm të jetë rikthyer.

7.4 MONITORIMI

7.4.1. Sistem i brendshëm monitorimi do të vendoset në NPRRSH/PESR, që do të përbëhet nga:

- Monitorimi i progresit të inputeve dhe outputeve që mat nëse inputet dërgohen me kohë dhe siç është përkufizuar në KBT/LAF -në dhe PBT/LAP e ardhshme; dhe

- Matje periodike të indikatorëve të prodhimit përkundër kushteve minimale, të fituara nëpërmjet hulumtimit.

7.4.2. Personi i pavarur, nga jashtë do të jetë konsulent me përvojë për qasje në tokat/rivendosjei angazhuar nga NPRRSH/PESR për të zbatuar monitorim. Tabela më poshtë paraqet shembull të indikatorëve që mund të përdoren për monitorim. Listë përfundimtare e indikatorëve do të zhvillohet në bazë të rezultateve të hulumtimit dhe do të inkorporohet në PBT/LAP .

Tabela7-1 – Shembuj të Indikatorëve të Monitorimit

Zbatim i PBT/LAP -së	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i konfirmuar i PNP/PAP-it të regjistruar gjatë hulumtimit ▪ Numri i konfirmuar ipronarëve të tokave pronat e të cilët gjenden brenda tampon zonës së sigurisë prej 40metrave, të regjistruar gjatë hulumtimit ▪ Numri i PNP/PAP-it të rivendosur në pronat e tyre të reja për banim (të mbështetur nga organet për banesa sociale) ▪ Numri ipronarëve të tokave të cilët i kanë nënshkruar marrëveshjet e tyre për kompensim ▪ Numri i PNP/PAP-it të cilët veç më kanë pranuar kompensimin e tyre ▪ Numri i konsultimeve publike dhe diskutimeve që janë mbajtur me grupet e fokusit ▪ Numri dhellose të ankesave të parashtruara, norma e zgjidhjes së ankesave me sukses, numër i ankesave të pazgjidhura ▪ Koha e aktiviteteve të zbatuara në krahasim me orarin për zbatim të PBT/LAP -së ▪ Shuma e fondeve totale të shpenzuara për zbatimin e PBT/LAP dhe norma e shpenzimit
Ndihmë për PNP/PAP e lëndueshëm me punësim dhe rikthim të ekzistencës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numër dhellose të programeve për punësim/gjenerim të të ardhurave të ofruara nga kategoritë relevante të PNP/PAP-it ▪ Numri i PNP/PAP të lëndueshëm që kanë marrë pjesë në bletari dhe këshilldhënie për biznese të vogla për të plotësuar të ardhurat ▪ Numri i fëmijëve PNP/PAP dhe të rriturve të ri të regjistruar në arsim, lloj i ndihmës së siguruar ▪ Numri i individëve të cilët me sukses kanë filluar aktivitete të reja për gjenerim të të ardhurave dhe mund të mbajnë veten në mënyrë të qëndrueshme
Program për ndihmë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri dhe lloji i programeve/bisedave të organizuara për ndihmë dhe që janë pranuar nga PNP/PAP ▪ Numri i pjesëmarrësve që kanë marrë pjesë në këto takime
Ndihmë me sigurim të dokumentacionit për PNP/PAP të paevidentuar (nëse mund të realizohet)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri dhe lloji i dokumenteve personale të siguruar për PNP/PAP-it që nuk janë të evidentuar
Shfrytëzim i ndihmës sociale dhe mbrojtjes shëndetësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i PNP/PAP të lëndueshëm që kanë shfrytëzuar ndihmë sociale dhe lloji i ndihmës së siguruar ▪ Number personave të lëndueshëm (p. sh. me pengesa/me sëmundje kronike, pleq që jetojnë vetëm, etj) të cilëve u është siguruar mbrojtje shëndetësore dhe trajtim përkatës

- 7.4.3. NPRRSH/PESR will include monitoring data and progress reports on PBT/LAP and its activities in quarterly reports during the land acquisition and compensation process and summarise relevant information in their annual reports to EBRD as required by the overall Environmental and Social monitoring of the Project.

8 PUBLIKIMI I INFORMATAVE DHE KONSULTIMEVE

8.1 ANGAZHIM I PLANIFIKUAR I ARDHSHEM I FAKTORËVE

- 8.1.1. NPRRSH/PESR është e përkushtuar për publikim të informatave relevante para opinionit dhe personave të prekur lidhur me Projektin për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të informuar. KBT/LAF -ja së bashku me dokumentet tjera të Projektit do të ngarkohet në uebsajtin e NPRRSH/PESR. Kopje të printuara të KBT/LAF -së, PAF-të, **ESAP** dhe Përmbledhjes Jo-Teknike të **ESIA**-snë gjuhë maqedonase dhe shqipe do të jenë në dispozicion në vetëqeverisjen lokale.
- 8.1.2. KBT/LAF -ja do të jetë në dispozicion në maqedonisht, shqip dhe anglisht për shqyrtim dhe komente, duke filluar nga muaji dhjetor 2020, si pjesë e pakos së publikuar të **ESIA**-s. Verzion elektronik i këtij dokumenti do të jetë në dispozicion së paku 120 ditë në këto uebsajte:
- uebsajti i NPRRSH/PESR: www.roads.org.mk
 - uebsajti i EBRD: <http://www.ebrd.com>
- 8.1.3. Kopje të shtypura gjithashtu do mund të gjenden në:
- NPRRSH/PESR në Shkup –rr. Dame Gruev 14, 1000 Shkup;
 - Komuna Kërçovë;
 - fsh. Bukojchani;
 - fsh. Strogomishte e Sipërme;
 - fsh. Strogomoshte e Poshtme, dhe;
 - fsh. Cërvivci.
- 8.1.4. Takimet publike dhe konsultimet e faktorëve me përfaqësues të vetëqeverisjes lokale do të organizohen nga NPRRSH/PESR në pajtim me Planin për Angazhim të Faktorëve (PAF) për publikim të ESIA-s dhe të informatave lidhur me këtë Kornizë.
- 8.1.5. Për zbatim të kësaj Kornize, është e rëndësishme të zbatohen intervista dhe takime të ndar me meshkuj dhe gra për të grumbulluar informata ndarazi për masat e preferuara për rikthim të ekzistencës dhe të kërkohet fidbeku i tyre lidhur me masat e propozuara për zbutje dhe kompensim. Aktivitetet këshilldhënëse duhet të ndjekin orarin e Projektit dhe duhet të fillojnë para aktiviteteve ndërtimore.
- 8.1.6. Detajet konkrete për këto ngjarje, duke përfshirë datat dhe kohën do të paraqiten në versionin e reviduar të Planit për Angazhim të Faktorëve (PAF) dhe do të bëhen publike nëpërmjet njoftimeve në uebsajtet përkatëse të përmendura dhe në tabelat e shpalljeve të Komunës.
- 8.1.7. Gjatë periudhës së publikimit, gjithashtu do të mbahet takim me PNP/PAP e lëndueshëm rom dhe pronarët e tokave, pronat e të cilëve gjenden në zonën prej 40metrave, për t'ua prezantuar këtë Kornizë, për të pranuar fidbek drejtpërsëdrejti nga këto grupe të prekura të persoaneve dhe t'i paraqesin preferencat e tyre në Planin për Blerje të Tokës dhe Kompensim që do të përgatitet nga NPRRSH/PESR.

- 8.1.8. Udhëzues për Blerje të tokave dhe Kompensim (UBTK) afishe do të sigurohet për personat e prekur nga projekti dhe do të publikohet në uebsajtin e NPRRSH/PESR.

9 MEKANIZËM PËR ANKESA

- 9.1.1. Mekanizmi për ankesa që do të vendoset sipas PAF-it do të përdoret për të grumbulluar fidbek, çështje dhe komente lidhur me KBT/LAF -në dhe procesin e blerjes së tokës si dhe rikthimin e ekzistencës, më përgjithësisht. Do të themelohet herët gjatë procesit për të pranuar dhe shqyrtuar komente dhe pyetje të faktorëve me kohë dhe për të ofruar informata shtesë mbi kompensimin dhe masat për rikthim të ekzistencës për personat e prekur nga projekti.
- 9.1.2. NPRRSH/PESR ka zhvilluar mekanizëm për ankesa për të pranuar dhe për të shqyrtuar të gjitha komentet dhe ankesat lidhur me Projektin, duke i përfshirë ato në lidhje me blerje të tokës. Parimet në vijim do të vlejné për menaxhimin me ankesat:
- Çdo ankesë në lidhje me blerje të tokës apo çështje tjetër projekti do të regjistrohet, do të pranohet brenda 5 ditëve të punës dhe do të monitorohet derisa të përmbyllet;
 - Sistemi për menaxhim me ankesa do të përfshin së paku një nivel apelimi, për të arritur zgjidhje të dyanshme aty ku është e mundur pa u futur në procedura gjyqësore;
 - Ankesat do të përpunohen dhe do të përgjigjen në afat prej 30 ditëve të punës.
- 9.1.3. NPRRSH/PESR do të vendos regjistër të ankesave dhe do ta monitorojë zgjidhjen e tyre në aspekt kohor. Çdo ankesë do të regjistrohet në regjistër me informatat në vijim:
- Përshkrim i ankesës;
 - Data kur është pranuar
 - Data e njohjes së dërguar te pala;
 - Përshkrim i masave që janë ndërmarrë (hulumtim, masa korrigjuese); dhe
 - Data e zgjidhjes dhe e përmbylljes / sigurim i fidbekut për parashtruesin e ankesës.
- 9.1.4. Çdo person apo organizatë mund personalisht të dërgojë komente dhe/apo ankesa, nëpërmjet telefonit, me postë apo e-mail tek:

Znj Biljana Cvetkoviç, Sektori për Çështje Juridike

Tel: + 389 (0)2 3118-044 ext.312

Fax: + 389 (0)2 3220-535

E-mail: biljanal@roads.org.mk

Adresa: Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore,

Dame Gruev 14,

1000 Shkup,

Republikae Maqedonisë së Veriut

10 PËRGJEGJËSI INSTITUCIONALE

- 10.1.1. Përgjegjës për zbatimim të kësaj KBT/LAF -je është NPRRSH/PESR.
- 10.1.2. Sektori për blerje të tokës dhe për çështje juridik i NPRRSH/PESR do të udhëheqë procesin për blerje të tokës dhe do të përkrahet nga punonjës tjerë të NPRRSH/PESR kur ka nevojë, duke përfshirë për shembull anëtarë të ekipit NPRRSH/PESR E&S. NPRRSH/PESR do të pranon informata lidhur me ankesat që janë parashtruar në Sektorin për çështje juridike lidhur me blerjen e tokave dhe do të punojë me repartin juridik për zgjidhjen e këtyre ankesave.
- 10.1.3. NPRRSH/PESR do të përpilojë draft raporte monitorimi për Bankën, që do të shqyrtohet nga menaxhmenti i lartë i NPRRSH/PESR dhe do të dërgohet në EBRD.
- 10.1.4. Ndihmë për sigurim të PNP/PAP të lëndueshëm me qasje në mundësitë për punësim dhe mirëqenie sociale do të sigurohet nga institucionet përkatëse dhe punojësit social të Komunave të përfshira. Dhënësit tjerë të shërbimeve mund gjithashtu të jenë të përfshirë, varësisht nga nevojat e PNP/PAP të prekur dhe programeve në dispozicion për ankesa.

Appendix A

MEKANIZMI PËR ANKESË

FORMULAR PËR REGJISTRIM TË ANKESËS	
INFORMATAT PËR KONTAKT	
Emri:	Gjinia: <input type="checkbox"/> Mashkull / <input type="checkbox"/> Femër
Adresa:	
Komuniteti:	Telefoni:
Komuna:	E-mail:
Ankesë Anoniye : <input type="checkbox"/> Po / <input type="checkbox"/> Jo	Forma e preferuar e komunikimit për informatë kthyesë: <input type="checkbox"/> Postë / <input type="checkbox"/> Telefon / <input type="checkbox"/> E-mail
PËRSHKRIMI I ANKESËS / SUGJERIMIT / PYETJES	
Ju lutemi jepni detaje (kush, çka, ku, kur) të ankesës suaj më poshtë:	
Nëse ankuesi ka ndërmarrë ndonjë veprim tjetër në lidhje me çështjen e ankesës, ju lutemi jepni detaje për veprimet e mëparshme (nëse ka):	
Ju lutemi jepni detaje për zgjidhjen tuaj të sugjeruar për ankesën:	
DETAJET E REGISTRITIMIT	
Emri i regjistruarit	
Organizata:	Pozita:
Si u parashtrua ankesa: <input type="checkbox"/> personalisht / <input type="checkbox"/> postë / <input type="checkbox"/> e-mail / <input type="checkbox"/> telefon / <input type="checkbox"/> faks / <input type="checkbox"/> _____	Lloji i ankesës: <input type="checkbox"/> Siguri / shqetësim rrugor: Zhurmë, Pluhur / Dëmtim të Aseteve (mjeteve) të prekura
Dokumentet e bashkëngjitura:	Ankesa është relevante për Projektin: <input type="checkbox"/> Po / <input type="checkbox"/> Jo nëse "Jo" u dërguar te: _____
Shënime:	
Nënshkrimi of regjistruarit:	Data e ankesës:

Appendix B

PBTTABELAE PËRMBAJTJES

1. Hyrje

1.1. Objektivi dhe fushëveprimi i dokumentit

1.2. Përshkrimi i projektit

1.3. Statusi i aktiviteteve të blerjes së tokës

1.3.1. Statusi i tanishëm i blerjes së tokës

1.3.2. Procesi i planifikuar për blerje të tokës

2. Informacioni bazë

2.1. Rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe sondazhit të inventarit të aseteve

2.2. Rezultatet e sondazhit socio-ekonomik

2.3. Impaktet ekonfirmuara

2.4. Listat e aseteve dhe palëve të prekura

3. Parimet dhe definicionet kryesore për kompensim (sipas LRF)

4. Përmbledhje e kompensimit dhe të drejtave (për kompensim)

5. Publikimi i informacionit dhe konsultime publike

5.1. Data e mbajtjes së publikimit të informacionit dhe konsultimeve publike

5.2. Plani për publikimin e informacionit dhe konsultimeve publike

5.2.1. Dokumentet dhe informacionet që planifikohen të publikohen

5.2.2. Takimet e planifikuara-

5.2.3. Tabela me orarin e takimeve publike

6. Implementimi i PBT

6.1. Përgjegjësitë për implementim

6.2. Shpenzimet e përlogaritura në bazë të dhënave të grumbulluara me sondazh

6.3. Monitorimi dhe Raportimi

7. Mekanizmi për ankesë dhe Detajet për kontakt

